**VENDIM**
**Nr. 248, datë 29.3.2017**

# PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR KULTIVIMIT DHE TRAFIKIMIT TË KANABISIT 2017–2020[1]

*(Ndryshuar me VKM nr.313, datë 31.5.2018)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Drejtësisë, ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, për të cilat në Planin e Veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

[1] VKM nr. 248, datë 29.3.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.65, datë 30 mars 2017.
VKM nr. 313, datë 31.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.81, datë 5 qershor 2018.

PLANI STRATEGJIK I VEPRIMIT KUNDËR KULTIVIMIT DHE TRAFIKIMIT TË KANABISIT
2017–2020
*(Zëvendësuar teksti i planit me VKM nr.313, datë 31.5.2018)*

**Akronimet dhe shkurtimet**

| | |
|---|---|
| ALUIZNI | Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit, Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DAR | Drejtoria Rajonale Arsimore |
| DPD | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave |
| DPT | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| DPPPP | Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave |
| EMCDDA | European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction |
| ERICP | European Reporting Instrument for Sites Related to Cannabis Production |
| EUROPOL | European Police Office |
| FA | Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë |
| ILDKPKI | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave Interesave |
| INTERPO | International Criminal Police Organization |
| INCB | Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| IZHA | Instituti i Zhvillimit Arsimor |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KN | Komiteti Ndërinstitucional |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MK | Ministria e Kulturës |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| OJF | Organizata jofitimprurëse |
| PKKK | Plani Kombëtar kundër Kanabisit |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PSH | Policia e Shtetit |
| SIVHD | Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare |
| SHÇBA | Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat |
| SHISH | Shërbimi Informativ i Shtetit |
| TAIEX | Technical Assistance and Information Exchange Instrument of European Comm Commission |
| TFQ | Task-Forca Qendrore |
| TFV | Task-Forca Vendore |
| UNODC | United Nations Office on Drugs and Crime |

**Përmbledhje ekzekutive**

Hartimi i Planit Kombëtar kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit ose shkurtimisht Plani Kombëtar kundër Kanabisit (PKKK) është diktuar nga nevoja për të parandaluar, goditur dhe shkatërruar dukurinë e kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit. Nëpërmjet këtij plani, qeveria shqiptare, parashikon bashkëpunim ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe koordinim në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme duke angazhuar të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare për parandalimin dhe shkatërrimin e kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit në vend.

Hartimi i këtij Plani paraprihet nga Strategjia Kombëtare Antidrogë 2004–2010 dhe Strategjia Kombëtare kundër Drogës 2012–2016. Vlerësimi për shkallën e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Antidrogë 2004–2010 konfirmon suksesin që ka pasur lidhur me reduktimin e prodhimit dhe trafikimit të drogave, si dhe sigurimit të një kontrolli efektiv të territorit. Strategjia Kombëtare kundër Drogës 2012–2016, materializonte

angazhimin e strukturave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese për të arritur standardet ndërkombëtare në luftën ndaj drogës dhe objektiv kryesor kishte krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes reduktimit të ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm. Një mangësi e kësaj Strategjie është qasja e pjesshme, si rezultat i së cilës arritjet nuk kanë kapur nivelin e pritshmërive dhe mundësive.

Në vend të hartimit të një strategjie të re, qeveria shqiptare ka vendosur të miratojë dhe të zbatojë Planin Kombëtar kundër Kanabisit.

PKKK-ja mban në konsideratë faktorët bazë që nxisin kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike në vend, ndër të cilët mund të përmendim: kushtet ende të vështira social-ekonomike, kërkesën ndërkombëtare përherë në rritje, zbatimin e standardeve të ndryshme ligjore në vendet e destinacionit për konsumin e drogës, bashkëpunimin e ngushtë të rrjeteve kriminale në vend me rrjetet kriminale të Bashkimit Evropian, si dhe fuqinë financiare dhe fleksibilitetin për t'iu adaptuar këtyre grupeve.

Theksi kryesor i PKKK-së është përpjekja e përbashkët ndërinstitucionale për goditjen e gjithanshme dhe frontale me qëllim identifikimin, zbulimin dhe shkatërrimin e grupeve dhe rrjeteve kriminale që janë aktive në fushën e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit dhe jo vetëm.

Një tjetër risi e rëndësishme e PKKK-së është mënyra se si matet suksesi i institucioneve dhe strukturave të ngarkuara me parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe përdorimit të kanabisit në vend. Indikatorët kryesorë matin kryesisht suksesin në identifikimin, zbulimin, ndalimin dhe vënien përpara drejtësisë të financuesve dhe drejtuesve të grupeve dhe rrjeteve kriminale.

Në ndryshim nga qasjet e mëparshme strategjike dhe praktika e ndjekur nga organet ligjzbatuese, PKKK-ja e orienton përpjekjen e institucioneve në fazat e hershme të ciklit të kultivimit të kanabisit, duke synuar që suksesi të arrihet duke parandaluar futjen e farërave në vend dhe duke goditur bimët në fazën kur ato janë fidanë, në mjedise të mbyllura, në sipërfaqe relativisht të vogla dhe kryesisht pranë zonave të banuara.

Identifikimi dhe sekuestrimi i aseteve të krijuara nga veprimtaritë kriminale është një tjetër kriter i rëndësishëm për të matur shkallën e suksesit në përballjen me fenomenin e kanabisit.

PKKK-ja nuk konsideron sukses shkatërrimin e parcelave në fazën e vonë të ciklit të kultivimit, kur bimët janë të pjekura për korrje, por njeh si sukses parandalimin e mbjelljes së tyre si kriter optimal ose shkatërrimin kur ato janë ende fidanë, si kriter të pranueshëm. Zbulimi dhe asgjësimi i bimëve narkotike në fazën e fundit të ciklit konsiderohet si një situatë ekstreme, e cila i ngarkon me përgjegjësi të lartë të gjitha autoritetet përgjegjëse.

Përveç theksit të fortë goditës kundër grupeve, rrjeteve dhe financave kriminale që nxisin dhe organizojnë kultivimin dhe trafikimin e kanabisit, PKKK-ja i kushton një rëndësi të veçantë masave që kontribuojnë në shkurajimin e qytetarëve për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme në këtë fushë. Një paketë shumë e gjerë masash, që synojnë zhvillim të qëndrueshëm duke nxitur dhe mbështetur veprimtarinë ekonomike të ligjshme në zonat dhe komunitetet e prekura, lehtësimin e barrës fiskale dhe mbështetjen sociale për individët dhe komunitetet nën risk, është përcaktuar në PKKK. Gjithashtu, intensifikimi i komunikimit publik në interes të ndërgjegjësimit të qytetarëve, reduktimit të përdorimit të kanabisit dhe bashkëpunimit të gjerë qytetar në përpjekjen e përbashkët kundër kanabisit është një prioritet i rëndësishëm i këtij Plani.

Koordinimi dhe bashkëveprimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar është një ndër risitë më të rëndësishme të PKKK-së.

Duke vlerësuar se përballimi i suksesshëm i kultivimit, trafikimit apo përdorimit të kanabisit nuk mund të kryhet vetëm me forcat e policisë dhe organeve të tjera ligjzbatuese, parashikohet një bashkëveprim i ngushtë i shumë aktorëve të tjerë shtetërorë, ku rol të veçantë marrin ato të bujqësisë, mjedisit, çështjeve sociale, shëndetësisë, arsimit dhe sidomos autoritetet e pushtetit vendor. Për këtë qëllim, parashikohet ngritja dhe funksionimi i strukturave të përbashkëta (task-forcë), si në nivelin qendror ashtu edhe atë lokal.

Një prioritet tjetër i rëndësishëm në arritjen e suksesit në luftën kundër kanabisit është përmes bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë: mësimi nga eksperienca (përvoja) e tyre, mbështetja logjistike dhe financiare nga partnerët, si dhe shkëmbimi i informacionit për të kuptuar kërkesën për kanabis në tregun ndërkombëtar të drogave dhe organizimi i operacioneve të përbashkëta do të jenë disa nga veprimtaritë e drejtuara në këtë aspekt.

Ky Plan do të monitorohet periodikisht dhe do të rishikohet në bazë vjetore, me qëllim vlerësimin e arritjeve në përmbushjen e objektivave të specifikuar në të, si dhe rishikim dhe rivlerësim të këtyre objektivave për t'iu adaptuar situatës së re.

Një Komitet Ndërinstitucional i kryesuar nga ministri i Brendshëm, një Task-Forcë Qendrore dhe Task-Forca Vendore pranë çdo prefekture, përbëjnë strukturën drejtuese që drejton, koordinon dhe kontrollon

punën e institucioneve të ngarkuara me zbatimin e PKKK-së.

## KAPITULLI I
## VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM PËR GJENDJEN E KANABISIT NË SHQIPËRI

### 1. Hyrje

### 1.1 Kuadri ligjor dhe strategjik në fuqi

Shqipëria ka një kuadër të gjerë dhe të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike që adresojnë çështjet e lëndëve narkotikëve. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme është lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike, trafikut të drogave dhe krimit të organizuar.

Kodi Penal klasifikon si vepër penale dhe parashikon dënim, për: i) prodhimin, kultivimin dhe shitjen e narkotikëve; ii) nxitjen/promovimin e prodhimit dhe konsumimin e lëndëve narkotike; iii) mbajtjen apo prodhimin e substancave të ndryshme kimike që janë bazë apo mund të përdoren për prodhimin e lëndëve të ndryshme kimike; si dhe iv) përshtatjen e ambienteve për përdorimin e narkotikëve. Gjithashtu, në kuadër të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike janë miratuar konventa, ligje specifike, akte nënligjore, si dhe janë hartuar dokumente strategjikë e programe, duke krijuar bazën e nevojshme rregullatore. Lista e dokumenteve kryesore, të cilave u referohet ky plan gjendet në shtojcën nr. 1, pjesë përbërëse e tij.

### 1.2 Vështrim i përgjithshëm – identifikim i faktorëve ndikues

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit është evidentuar si fenomen në Shqipëri që në vitin 1991. Vitet në vijim kanë shënuar një duel të pandërprerë mes institucioneve ligjzbatuese dhe rrjeteve apo grupeve të trafikimit. Kultivimi i kanabisit ka marrë trajta shqetësuese sidomos nga viti 1997 dhe më tej. Tolerimi i rrezikshëm i kultivimit të hapur të kanabisit në komunën e Lazaratit, të qarkut Gjirokastër, krijoi kushte të favorshme për grupet kriminale, të cilat, për më shumë se një dekadë, arritën të konsolidojnë financat, rrjetet, tregjet dhe lidhjet politike. Modeli negativ i krijuar në Lazarat ndikoi shumë, jo vetëm në fuqizimin e shumanshëm të grupeve dhe rrjeteve kriminale, por edhe në inkurajimin e kultivimit të kanabisit në rajone të tjera të vendit, si dhe në përkeqësimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë.

Goditja e suksesshme kundër grupeve dhe rrjeteve kriminale në Lazarat, në vitin 2014, nxori në dritë edhe përmasat e tjera që kishte marrë fenomeni pothuajse në të gjitha qarqet e vendit. Kjo goditje e fortë solli si pasojë që energjitë kriminale të përqendruara në këtë rajon të shpërndahen në drejtime të tjera në të gjithë vendin. Rritja e fuqisë goditëse të institucioneve ligjzbatuese dhe përmirësimi i kontrollit të hapësirës tokësore e detare ka bërë që grupet kriminale të zhvendosin kultivimin e bimëve narkotike në zona të thella apo në mjedise të mbyllura dhe të diversifikojnë rrugët e trafikimit, duke përfshirë edhe ato më komplekset, siç është përdorimi i avionëve sportivë dhe motorëve të ujit.

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për goditjen e kultivimit të bimëve dhe trafikimit të lëndëve narkotike, Shqipëria ende përballet me praninë e këtij fenomeni të dëmshëm për rendin publik, shëndetin, mirëqenien sociale, ekonominë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Faktorë kryesorë ndikues në fenomenin e kultivimit dhe trafikimit janë problemet social-ekonomike, që në kombinim me pozicionin gjeografik dhe kushtet klimaterike të favorshme për kultivim të çdo lloj bime, krijojnë premisa që kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike të konsiderohet një veprimtari fitimprurëse. Grupet kriminale shfrytëzojnë varfërinë, papunësinë, nivelin e ulët arsimor dhe mungesën e programeve zhvillimore alternative, për të angazhuar në aktivitetet e tyre kriminale persona me premtimin e përfitimeve të shpejta financiare.

Mungesa e aftësisë së organeve ligjzbatuese për të luftuar grupet e organizuara kriminale, është një tjetër faktor i rëndësishëm. Sofistikimi i tyre, i formave, mënyrave dhe *modus operandi*, që vjen si rrjedhojë edhe nga kërkesa e lartë për lëndë narkotike, kryesisht në tregun e jashtëm, kanë vështirësuar punën e organeve ligjzbatuese. Mungesa e informacioneve për fazën e parë të kultivimit të bimëve narkotike, veçanërisht në fazat e para të ciklit të prodhimit të bimëve narkotike (kur ato janë në serra, magazina, depo, tunele të paadministruara), për personat që sigurojnë farën e kanabisit, për ata që përgatisin fidanët dhe për personat që blejnë pesticide për këto bimë në farmacitë bujqësore, pengon organet ligjzbatuese për kapjen në flagrancë të autorëve pjesë e grupeve kriminale, por kryesisht atyre që kryejnë shërbimet, si: mbjellje, ujitje, plehërim dhe pastrim të bimës narkotike.

Gjithashtu, faktor tjetër ndikues është pamjaftueshmëria e kontrollit efektiv të territorit, nisur edhe nga fakti se, bimët narkotike kultivohen kryesisht në pyje dhe kullota të largëta në pronësi të shtetit (pyjet dhe kullotat në zonat e mbrojtura apo të braktisura).

Emigracioni, mundësoi njohjen dhe lidhjen e grupeve kriminale të vendit me grupet e krimit të

organizuar në vendet e Evropës Perëndimore, për trafikimin e narkotikëve. Si rrjedhojë, strukturat e luftës ndaj krimit të organizuar dhe shërbimet e kontrollit të kufirit kanë rritur bashkëpunimin me strukturat përkatëse të vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian (BE) për të identifikuar dhe goditur grupet kriminale.

Gjithashtu, dobësitë në bashkëpunimin ndërinstitucional kanë sjellë mungesën e analizave dhe vlerësimeve të përbashkëta të gjendjes në terren. Organizimi vertikal i strukturave të Policisë së Shtetit pengon integrimin e informacioneve dhe kontributeve që vijnë nga sektorë të caktuar policorë, si: qarkullimi rrugor, kontrolli i kufirit, patrulla e përgjithshme, duke sjellë kufizime në vlerësimin e situatës në nivel vendor (komisariati). Mungesa e bashkëpunimit të strukturuar dhe formalizuar ndërmjet strukturave vendore të Policisë, Prokurorisë dhe institucioneve të tjera shtetërore, si: shërbimi pyjor, strukturat e bujqësisë, strukturat arsimore, autoritetet tatimore dhe doganore, shërbimet inteligjente dhe strukturat e pushtetit vendor vështirëson kontrollin efektiv të territorit, krijimin e një tabloje të plotë e të qartë të gjendjes, si dhe reagimin efektiv për parandalimin e kultivimit, goditjen dhe trafikimin e lëndëve narkotikëve.

Gjithashtu, mungesa e menaxhimit efikas të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike nga strukturat vendore të policisë për përdorimin e metodave speciale të hetimit për zbulimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike ngadalëson reagimin e duhur institucional.

**1.3 Historia e fenomenit të kanabisit në Shqipëri që nga viti 1990**

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit në Shqipëri e ka zanafillën në fillim të viteve 1990, fillimisht duke u kultivuar në zonat Sarandë, Delvinë dhe Gjirokastër dhe gjatë viteve 1995–1996 në të gjitha qarqet e vendit. Kështu, gjatë vitit **1995** janë identifikuar dhe asgjësuar nga strukturat e Policisë së Shtetit **167.417** bimë narkotike dhe në vitin **1996** janë identifikuar/asgjësuar **383.968** bimë narkotike ose **2.2 herë më shumë** se gjatë vitit 1995.

Si rezultat i kësaj veprimtarie, filloi edhe trafikimi brenda dhe jashtë vendit i lëndëve narkotike kryesisht në Itali, Greqi, si dhe në vende të tjera.

Praktika e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit u intensifikua gjatë dhe pas vitit 1997, si pasojë e mosfunksionimit të institucioneve shtetërore, kryesisht atyre të sigurisë e të inteligjencës.

Numri i bimëve narkotike të identifikuara dhe asgjësuara në veçanti gjatë periudhës 1997–2013 nuk është plotësisht i saktë për shkak se, për këtë periudhë, strukturat e Policisë së Shtetit nuk kanë mundur të realizojnë ndërhyrje të plota në zonën e Lazaratit për asgjësimin e bimëve narkotike të kultivuara. Referuar raporteve të Guardia Di Finanza, nga monitorimi ajror i kryer me avionë special në vitin 2012 dhe 2013 mbi zonën e Lazaratit, është konstatuar se, në këtë zonë janë kultivuar përkatësisht **383 ha** në vitin 2012 dhe **319 ha** në vitin 2013.

Deri në vitin 2014, qendra kryesore të prodhimit të nënprodukteve të kanabisit ishin **Lazarati**, në jug dhe **Dukagjini** në veri të vendit. Në mes të vitit 2014, dy operacione shumë të suksesshme policore janë kryer në këto dy zona dhe si pasojë u shkatërruan një numër shumë i madh i bimëve të kanabisit dhe një sasi e madhe e marijuanës.

Goditja e suksesshme që realizoi Policia e Shtetit në vitin 2014 për asgjësimin e bimëve narkotike në zonat e Lazaratit dhe Dukagjinit, si dhe mbajtja e këtyre dy zonave nën kontroll të vazhdueshëm, ndikoi në: i) rritje të çmimit të kanabisit, si rrjedhojë e mungesës së; dhe ii) zhvendosje të aktivitetit të grupeve kriminale në zona të tjera në të gjithë territorin, duke u reflektuar në rritjen e numrit të bimëve narkotike të kultivuara gjatë viteve 2015 dhe 2016. Në vitin 2015, u identifikuan dhe asgjësuan **797.422** bimë kanabis të kultivuara, kurse në vitin 2016 rezultojnë të identifikuara dhe të asgjësuara **2.534.120** bimëv kanabis, numri më i lartë i bimëve të asgjësuara në historinë e shtetit shqiptar, mbi **3 herë** më i lartë krahasuar me totalin e bimëve të asgjësuara në vitin 2015.

Për periudhën **1995–2016** janë identifikuar/asgjësuar gjithsej **6.944.092** bimë narkotike ose mesatarisht **289.337** bimë narkotike në çdo vit, grafikisht si më poshtë:

*Grafiku 1. Totali i bimëve narkotike të identifikuara/asgjësuara gjatë periudhës 1995–2016*




Përgjatë periudhës 2006–2016, në lidhje me këto sasi të identifikuara dhe asgjësuara janë proceduar penalisht **1.826 autorë** në total, grafikisht si më poshtë:

*Grafiku 2. Numri i autorëve të proceduar penalisht për kultivim narkotikësh, për periudhën 2006–2016*




Për sa i përket trafikimit, tabela e mëposhtme paraqet informacion mbi rastet e identifikuara, sasitë e sekuestruara dhe numrin e autorëve të proceduar penalisht gjatë periudhës 2006–2016.

*Tabela 1. Rezultate në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike në vitet 2006–2016, paraqitet si më poshtë:*

| Vitet | Rastet e kapura | Sasia e kanabisit, marijuanës, hashashit të sekuestruar | Sasia e vajit të hashashit të sekuestruar | Autorë të proceduar penalisht |
|---|---|---|---|---|
| **2006** | 199 | 6754 kg 207.1 g | 0.95 litra | 300 |
| **2007** | 121 | 7100 kg 600.8 g | - | 199 |
| **2008** | 191 | 3941 kg 313.3 g | - | 286 |
| **2009** | 232 | 3424 kg 479.4 g | 9.5 ml | 314 |
| **2010** | 380 | 7304 kg 805.8 g | - | 559 |
| **2011** | 507 | 7695 kg 658.8 g +32 kg 210.5 g hashash | 1 kg 584.2 g | 739 |
| **2012** | 823 | 21138 kg 231.4 g +5 kg 112.2 g hashash | 500 g | 1056 |
| **2013** | 956 | 20672 kg 916.9 g +32 kg 440.2 g hashash | 359 ml | 1147 |
| **2014** | 1096 | 97226 kg 101.9 g +24 kg 450 g hashash | 11 kg 154.4 g | 1328 |
| **2015** | 901 | 11 tonë 352 kg 829 g +60 kg 16 g hashash | 5 litra 818 ml | 1301 |
| **2016** | 1314 | 30 tonë 014 kg 991.02 g +22 kg 898.4 g hashash | - | 1739 |

Pavarësisht se, ndër vite është rritur numri i rasteve dhe individëve të proceduar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për veprat penale që lidhen me narkotikët, numri i rasteve të evidentuara dhe autorëve të identifikuar për vepra penale që lidhen me narkotikët të kryera në formën e organizatave kriminale mbetet kryesisht i ulët, siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm.

*Grafiku 3. Numri total i procedimeve penale të organizatave kriminale dhe grupeve të strukturuara kriminale për veprat penale në fushën e narkotikëve*




Lidhur me veprat penale të parashikuara nga neni 333 "Organizatë Kriminale" dhe nga neni 333/a "Grup i Strukturuar Kriminal", gjatë vitit 2016 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë regjistruar përkatësisht **1** dhe **29** procedime për vepra penale të ndryshme, ndërkohë janë gjykuar **2** çështje dhe janë dënuar **5** persona.

Vlen të theksohet se, konteksti në të cilin operojnë grupet shqiptare ka bërë që të ketë më shumë raste të regjistruara për veprën penale "Grup i Strukturuar Kriminal" se sa për veprën penale "Organizatë Kriminale". Në fakt, hetimet kanë treguar se, grupet shqiptare nuk përbëjnë një organizatë kriminale të mirëfilltë, e cila për të qenë e tillë duhet të ketë qëndrueshmëri në kohë, organizim vertikal, detyra të mirëpërcaktuara, financues të jashtëm, e karakterizuar nga kryerja e veprave penale jo gjithmonë të të njëjtit lloj. Ndërsa, në rastin e grupeve shqiptare që në të shumtën e rasteve janë proceduar për veprën "Grup i

Strukturuar Kriminal", bëhet fjalë për një grup personash me lidhje familjare (shpeshherë edhe 4 persona, babai, nëna dhe fëmijët), të cilët brenda grupit nuk pranojnë të kenë një organizim vertikal, por secili kërkon të ketë një rol të rëndësishëm në grup që operojnë për një periudhë 2–3-mujore (zakonisht në periudhën e përshtatshme të kultivimit), pra jo shtrirje të gjerë në kohë dhe kryejnë vetëm një lloj vepre penale.

Në vitin 2016, numri i procedimeve të regjistruara është rritur me 43%, krahasuar me vitin 2015. Për veprat penale të parashikuara nga neni 283 "Prodhimi dhe shitje e narkotikëve", neni 283/a "Trafikimi i narkotikëve" dhe neni 284 i Kodit Penal "Kultivimi i bimëve narkotikëve" janë regjistruar përkatësisht 39 %, 18,3 % dhe 48,7 % më shumë procedime, krahasuar me një vit më parë.

Në dy vitet e fundit, dënimet e dhëna nga gjykata, në pjesën më të madhe të rasteve kanë rezultuar në mesataren e kufijve të masës së dënimit të parashikuar në ligj.

Në arritjen e këtyre rezultateve gjatë dy viteve të fundit, institucioni që ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë barrën kryesore në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve ka qenë Policia e Shtetit (PSH). Pavarësisht se, ky institucion zhvillon veprimtari gjithëvjetore, ai i përqendron forcat dhe mjetet në periudhën qershor–shtator. Kjo periudhë përkon edhe me sezonin turistik për garantimin e rendit publik dhe të sigurisë në të gjitha plazhet dhe zonat turistike të vendit. Përveç kësaj, punonjësit e PSH-së angazhohen edhe në veprimtari të tjera për sigurinë publike, si: aktivitete sportive, kulturore dhe politike (zgjedhjet) etj.

Gjithashtu, gjatë këtyre dy viteve të fundit, kontributnë identifikimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike gjatë periudhës maj–shtator ka dhënë edhe Ministria e Mbrojtjes, ku helikopterët dhe mjetet e saj detare kanë monitoruar nga ajri dhe deti territorin dhe ujërat territoriale të vendit tonë. Janë realizuar mbi **441 orë** fluturimi të helikopterëve ushtarakë, që përveç përmbushjes së misionit të tyre kanë pasur si detyrë shtesë monitorimin e territorit dhe identifikimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë narkotike në korridoret e fluturimit ajror. Janë kryer edhe rreth **91 orë** lundrimi me mjetet e Forcave Detare në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë detare dhe në interes të përmbushjes së detyrës kundër trafikimit të lëndëve narkotike.

Strukturat e inteligjencës dhe zbatimit të legjislacionit ushtarak në Forcat e Armatosura kanë shkëmbyer informacion në kohë reale me Policinë e Shtetit, SHISH-in dhe Prokurorinë në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve.

Pavarësisht këtyre arritjeve, vihet re se, grupet kriminale vijojnë të ushtrojnë këtë aktivitet kriminal duke pasur destinacion shtetet, si: Italia, Greqia, vende të tjera të BE-së dhe në raste të veçanta edhe Maqedonia e Kosova. Elementë dhe grupe kriminale në vendin tonë, duke shfrytëzuar lëvizjen e lirë në shtetet evropiane kanë krijuar lidhje me elementë kriminalë në këto vende, duke mundësuar importimin e farave të bimëve narkotike, si dhe bashkëpunojnë me individë të tjerë për kultivimin e tyre në vendin tonë.

### 1.4 Kërkesa ndërkombëtare për kanabis

Kërkesa ndërkombëtare vlerësohet si elementi bazë, që motivon grupet kriminale vendëse dhe të huaja për t'u përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Tregues që provon peshën specifike të kërkesës ndërkombëtare është shpërpjesëtimi i dukshëm midis sasisë që prodhohet dhe përdoret në vend dhe sasisë që trafikohet jashtë. Standardet që aplikohen në vende të ndryshme për përdorimin e kanabisit dhe ndërlidhja e ngushtë e grupeve kriminale janë faktorë që ndikojnë në tendencën në rritje të kërkesës ndërkombëtare.

Kryesisht, destinacionet e kanabisit të prodhuar në Shqipëri janë vendet fqinje, si: Italia dhe Greqia, si dhe vende të tjera të BE-së, ku për trafikimin e kanabisit përdoren rrugët tokësore dhe detare. Gjatë viteve të fundit, aktiviteti i trafikimit të kanabisit është karakterizuar nga diversiteti i rrugëve të trafikimit me tendencë zgjerimin e rrugëve ekzistuese tokësore, detare dhe tentativave për trafikim nëpërmjet rrugëve ajrore të paidentifikuara më parë.

Përballë presionit përherë në rritje të organeve ligjzbatuese për të goditur fortë trafikimin e lëndëve narkotike, grupet kriminale po adaptojnë linja të tjera trafikimi.

### 1.5 Përdorimi i kanabisit në Shqipëri

Ndonëse shumë herë më e vogël se kërkesa ndërkombëtare, edhe kërkesa e brendshme për përdorimin e kanabisit ka njohur rritje, kryesisht te të rinjtë, në klubet e natës, mjediset turistike, lokalet luksoze, por dhe në institucionet arsimore.

Statistikat tregojnë rritjen e numrit të përdoruesve që kanë përdorur drogë, të paktën një herë gjatë gjithë jetës. Afërsisht **6.6%** e nxënësve e kanë provuar marijuanën të paktën një herë në jetë, krahasuar me **4.4%** që ishin në vitin **2011**. Nga anketimet apo studimet e pjesshme (deri më tani nuk ka pasur akoma një studim në rang kombëtar) rezulton se, numri i përdoruesve të drogave ka një rritje të ndjeshme. Në vitin **1995** numri i personave (15–65 vjeç), që kanë provuar një lloj droge të paktën një herë rezultonte rreth **5,000**, në vitin **1998** rreth **20,000,** ndërkohë që në vitin **2015** ky numër luhatet midis **27,000–29,000**.

Në vitin **2014**, rezulton se, **5.6%** e të rinjve shqiptarë janë përdorues të kanabisit, ndërsa në vitin **2015**, rreth **7%** e të rinjve të grup-moshës 14–19 vjeç kanë konsumuar kanabis.

Përvoja e përballjes me pasojat e përdorimit të narkotikëve në vend ka hasur disa probleme që adresohen në PKK, si:

- Mungesa e strukturave ambulatore publike, shërbimeve ditore dhe shërbimeve komunitare me akomodim për trajtimin e problemeve të drogave;
- Mungesa e shërbimeve sociale të specializuara që mundësojnë riintegrimin në shoqëri të personave të trajtuar nga shërbimet e specializuara;
- Pamjaftueshmëria e personelit të specializuar për trajtimin e problematikave të drogave dhe pasojave që krijohen në vijimësi nga varësia ndaj drogave;
- Mungesa e një sistemi kualifikimi për personelin shëndetësor në lidhje me trajtimin e drogave;
- Shkëputja e aktiviteteve të aktorëve të tjerë të organizatave jofitimprurëse (OJF) nga shërbimi i specializuar i Adiktologjisë së Qendrës Universitare, i cili është shërbimi i vetëm shkencor i specializuar për trajtimin e problematikave të varësisë ndaj drogave;
- Mungesa e barnave në shërbimet shëndetësore për trajtimin e abuzimit me substancat narkotike;
- Mbivendosja e aktiviteteve në fushën e edukimit dhe ndërgjegjësimit të publikut, si dhe paqëndrueshmëria e tyre për shkak të varësisë nga donatorët;
- Mungesa e një njësie të specializuar në nivel qendror që t'i kushtohet vetëm trajtimit të drogave dhe përgatitjes së strategjive;
- Mungesa e profilizimit të personelit shëndetësor për të dalluar vdekjet e ardhura si pasojë e përdorimit të drogave (mbidozë etj.) me vdekjet e shkaktuara nga arsye të tjera (kardiake, cerebrale etj.);
- Mungesa e bashkëpunimit të strukturave shëndetësore me ato informative përkatëse për të informuar mbi rastet e vdekjeve të shkaktuara nga droga;
- Mospërfshirja sa duhet i Laboratorit Toksikologjik të Institutit të Mjekësisë Ligjore për vërtetimin e rasteve të vdekjeve të shkaktuara nga përdorimi i drogave.

**1.6 Impakti negativ i kultivimit të kanabisit në Shqipëri**

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit ka ndikim negativ të konsiderueshëm në jetën ekonomike, shoqërore, politike, kulturore të vendit. Përveç dëmeve të mëdha që sjell për shëndetin e popullsisë, ky fenomen ndikon në cenimin e rendit dhe sigurisë publike, në avancimin e zhvillimit ekonomik, prishjen e imazhit të vendit dhe ngadalësimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian.

**2. Sfidat dhe problematikat për një qasje efektive**

Disa nga sfidat kryesore janë: mungesa e zbatimit të legjislacionit, nevoja për të forcuar kapacitetet e burimeve njerëzore, logjistike dhe financiare, nevoja për të luftuar korrupsionin, nevoja për të luftuar praktikat e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe dëmet e shkaktuara prej tyre. Gjithashtu, sfida të tjera janë nevoja për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe nevoja për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm kundër përfshirjes në kultivim apo trafikim të kanabisit.

**2.1 Zbatimi i legjislacionit në fuqi**

Zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi konsiderohet si një ndër sfidat e rëndësishme në përballjen me kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike. Veçanërisht problematike paraqitet shkalla e zbatimit të ligjit që parashikon përgjegjësi për autoritetet vendore, si: ligji "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope"[2] dhe ligji "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"[3]. Moszbatimi korrekt i ligjit ka sjellë neglizhencë të autoriteteve vendore kundër dukurisë së kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe pamjaftueshmëri të fuqisë goditëse mbi asetet kriminale të përfituara nga kjo veprimtari.

**2.2 Kapacitetet njerëzore dhe burimet logjistike e financiare**

Kapacitetet e kufizuara njerëzore, materiale dhe financiare konsiderohen si një ndër sfidat kryesore, ndaj në këtë kontekst shtimi i tyre ndihmon në arritjen e suksesit kundër dukurisë së kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike.

Problematika kryesore në këtë fushë, janë:

- Mungesa e një strukture përgjegjëse dhe të dedikuar për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që burojnë nga veprimtari veçanërisht të lidhura me prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, si dhe për drejtimin dhe koordinimin e përgjigjes së përbashkët ndërinstitucionale;
- Pamjaftueshmëria e monitorimit dhe kontrollit efikas mbi qarkullimin e parasë fizike, përmes kufijve të vendit;
- Mungesa e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të aseteve kriminale të sekuestruara/konfiskuara;
- Kufizimet e burimeve njerëzore, kryesisht në radhët e prokurorisë, policisë dhe shëndetësisë;

---

[2] Ligji nr. 7975, datë 21.7.1995, ndryshuar nga ligjet: nr. 9271, datë 9.9.2004 dhe nr. 9559, datë 8.7.2006.

[3] Ligj nr. 10192, datë 3.12.2009.

- Specializimi i pamjaftueshëm i prokurorëve, punonjësve të policisë dhe të shëndetësisë në çështjet specifike që lidhen me narkotikët;
- Kapacitete aktuale të kufizuara për trajtimin e përdoruesve;
- Pamjaftueshmëria e mjeteve të skanimit në pikat e kontrollit doganor;
- Mungesa e mjeteve të kalueshmërisë së lartë, mjeteve të vëzhgimit dhe mjeteve të tjera speciale;
- Kapacitete të kufizuara për monitorimin efektiv të hapësirës tokësore, detare dhe ajrore;
- Mungesa e kapaciteteve të specializuara për trajnimin e strukturave reaguese në fushën e narkotikëve;
- Mbingarkesa e punës e strukturave të rendit dhe sigurisë publike, për shkak të prioriteteve që kanë këto struktura, si: garantimi i rendit publik gjatë sezonit turistik veror, procesi zgjedhor, parandalimi i krimeve në fushën e mjedisit dhe parandalimi e goditja e kultivimit të bimëve narkotike;
- Kosto e lartë financiare e shërbimeve policore për identifikimin/asgjësimin e bimëve narkotike;
- Lëvizjet e shpeshta në detyrë të specialistëve për krimet në komisariatet e policisë ka sjellë mangësi në sigurimin e informacionit, si dhe njohjen e situatës kriminale të zonës;
- Ndryshimet e shpeshta strukturore në drejtoritë vendore të policisë dhe komisariatet e policisë;
- Mosplotësimi i organikës së komisariateve të Policisë me specialistë për krimet ka sjellë mungesë në kontrollin e territorit dhe mangësi në sigurimin e informacionit policor.

**2.3 Lufta kundër korrupsionit**

Në përhapjen e praktikës së kultivimit/trafikimit të kanabisit është i pashmangshëm ndikimi nga praktikat korruptive të nëpunësve dhe funksionarëve publikë, të cilët me veprimet ose mosveprimet e tyre kanë favorizuar kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike. Dyshime për raste korruptive janë ngritur edhe në fushën e goditjes së aseteve kriminale që rrjedhin nga veprimtaria e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike.

**2.4 Identifikimi dhe parandalimi i kultivimit të kanabisit**

Reduktimi i prodhimit të kanabisit përbën një nga sfidat kryesore, në funksion të përmbushjes së objektivave dhe qëllimeve prioritare të këtij plani.

Në këtë aspekt janë evidentuar disa nga faktorët që ndikojnë dhe krijojnë kushte të favorshme për kultivimin e bimëve narkotike, si më poshtë:

- Mosparashikimi në Kodin Penal i veprës penale të kultivimit të bimëve narkotike deri në vitin 1995;
- Gjendja e vështirë ekonomike e një pjese të madhe të popullsisë;
- Orientimi i kufizuar i projekteve sociale, kulturore, arsimore e bujqësore, drejt zonave të prekura;
- Pamjaftueshmëria e fushatave të ndërgjegjësimit për dëmet dhe pasojat e lidhura me kultivimin;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i njësive të vetëqeverisjes vendore mbi ndërgjegjësimin dhe orientimin e fermerëve drejt kultivimit të kulturave bujqësore apo prodhimeve blegtorale të ligjshme, të qëndrueshme dhe fitimprurëse;
- Fitimet e larta financiare që sigurohen nëpërmjet kultivimit;
- Mosgoditja e fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike në zonën e Lazaratit për periudhën 1997–2014;
- Mosofrimi i mundësive të përshtatshme nga platformat ekzistuese të raportimit për qytetarët që duan të sinjalizojnë rastet e kultivimit;
- Moszbatimi korrekt i legjislacionit përkatës, duke sjellë neglizhencë të autoriteteve vendore kundër fenomenit të kultivimit;
- Pamjaftueshmëria e strukturave të dedikuara për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel qendror dhe lokal;
- Niveli i ulët në shkëmbimin reciprok të informacionit midis strukturave përgjegjëse në nivel vendor;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i institucionit të prefektit në rolin koordinues midis institucioneve në nivel vendor;
- Mungesa e mjeteve të kalueshmërisë së lartë, mjeteve të vëzhgimit dhe mjeteve të tjera speciale;
- Kërkesa e lartë në tregjet ndërkombëtare për kanabis;
- Përfitimet e shpejta financiare dhe mundësitë e mëdha financuese nga grupet kriminale;
- Faktorët ekonomikë, socialë dhe kulturorë, si: varfëria, papunësia, niveli i ulët arsimor;
- Mungesa e programeve zhvillimore alternative;
- Pamundësia për kontrollin e plotë të territorit;
- Kushtet e favorshme klimaterike.

**2.5 Shkatërrimi i veprimtarisë së trafikimit të kanabisit**

Në kuadër të proceseve integruese dhe përmbushjes së angazhimeve në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafiqeve të paligjshme, sfidë e rëndësishme mbetet dhe goditja e trafikimit të lëndëve

narkotike.

Prodhimi i kanabisit ka një ndikim të drejtpërdrejtë në trafikimin e tij. Raporti mes prodhimit dhe trafikimit të kanabisit është një raport i drejtë, që do të thotë se kur rritet prodhimi, për pasojë rritet edhe trafikimi, si dhe rriten rastet e kapjes dhe sasitë e sekuestruara nga strukturat ligjzbatuese. Reflektimi i prodhimit te trafikimi kryhet zakonisht në vitin pasardhës, ku për shembull, gjatë vitit 2015, pati një rënie drastike të sasive të kanabisit të sekuestruar dhe të trafikuar, pasi në vitin 2014 u godit zona e rëndësishme e prodhimit të bimëve narkotike në Lazarat.

Si faktorë që favorizojnë trafikimin e lëndëve narkotike konsiderohen (edhe pse shumë prej tyre favorizojnë njëkohësisht edhe kultivimin), elementet e mëposhtme:

- Pozicioni i favorshëm gjeografik i vendit;
- Hapja e Shqipërisë ndaj vendeve të tjera pas një periudhe izolimi 50-vjeçare;
- Emigracioni i popullsisë drejt vendeve të tjera;
- Rritja e menjëhershme e lëvizjes së popullsisë nga brenda dhe jashtë vendit dhe anasjellas;
- Mungesa e shkëmbimit të informacionit të plotë mbi aktivitetet e grupeve të fuqishme kriminale;
- Pamjaftueshmëria e koordinimit ndërinstitucional në evidentimin dhe ndjekjen e grupeve kriminale;
- Ndikimi i aktivitetit të grupeve të organizuara kriminale ndërkombëtare, të pajisura me mjete teknologjike të avancuara dhe me kapacitete financiare të konsiderueshme;
- Fitimet e larta financiare që sigurohen nëpërmjet trafikimit të lëndëve narkotike;
- Situata e përgjithshme në rajonin e Ballkanit pas vitit 1991;
- Interesimi gjithnjë në rritje i organizatave kriminale të huaja që lidhen me këtë veprimtari, për të bashkëpunuar me grupe kriminale shqiptare në zgjerimin e aktiviteteve kriminale të trafikut, shpërndarjes së lëndëve narkotike etj.;
- Kërkesë-oferta në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar;
- Mosofrimi i mundësive të përshtatshme nga platformat ekzistuese të raportimit për qytetarët që duan të sinjalizojnë rastet e trafikimit të lëndëve narkotike;
- Moszbatimi efektiv i legjislacionit që parashikon përgjegjësi për autoritetet vendore, si: ligji “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope” dhe ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” etj.;
- Moszbatimi korrekt i legjislacionit përkatës, duke sjellë neglizhencë të autoriteteve vendore kundër fenomenit të trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe pamjaftueshmëri të fuqisë goditëse mbi asetet kriminale të përftuara nga kjo veprimtari;
- Pamjaftueshmëria e strukturave të dedikuara për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor;
- Dobësi në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në luftën kundër këtij fenomeni, si dhe pamjaftueshmëria e programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë;
- Mungesa e një strukture përgjegjëse dhe të dedikuar për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që burojnë nga veprimtari veçanërisht të lidhura me prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, si dhe për drejtimin dhe koordinimin e përgjigjes së përbashkët ndërinstitucionale;
- Pamjaftueshmëria e monitorimit dhe kontrollit efikas mbi qarkullimin e parasë fizike, përmes kufijve të vendit;
- Mungesa e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të aseteve kriminale të sekuestruara/konfiskuara;
- Kufizimet e burimeve njerëzore, kryesisht në radhët e prokurorisë, policisë dhe shëndetësisë;

Specializimi i pamjaftueshëm i prokurorëve, punonjësve të policisë dhe shëndetësisë në çështje specifike që lidhen me narkotikët;

- Kapacitete aktuale të kufizuara për trajtimin e përdoruesve;
- Pamjaftueshmëria e mjeteve të skanimit në pikat e kontrollit doganor;
- Kapacitete të kufizuara për monitorimin efektiv të hapësirës tokësore detare, ajrore;
- Mungesa e kapaciteteve të specializuara për trajnimin e strukturave reaguese në fushën e narkotikëve;
- Praktikat korruptive të nëpunësve dhe funksionarëve publikë, të cilët me veprimet, ose mosveprimet e tyre kanë favorizuar trafikimin e lëndëve narkotike;
- Kapacitetet e kufizuara të Njësive të Inteligjencës Financiare.

**2.6 Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar**

***Bashkëpunimi me institucionet e tjera ligjzbatuese***

Vlerësohet bashkëpunimi midis strukturave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, si p.sh., në trajtimin e informacioneve të ardhura nga Shërbimi Informativ i Shtetit, mundësuar dhe falë një Marrëveshjeje Bashkëpunimi midis SHISH-it dhe Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, informacionet e ardhura nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat janë

administruar, verifikuar dhe ndjekur në kohën e duhur dhe janë hedhur në (hartën digjitale) sistemin elektronik "ALFA-GIS" dhe ecuria/dinamika e tyre ndiqet në mënyrë të vazhdueshme. Në praktikë, bashkëpunimi konkretizohet në rastet e konstatimit të kultivimit të bimëve narkotike në terren, informohen në kohë strukturat vendore të SHÇBA-së dhe prokurori i gatshëm, si dhe kryhen të gjitha veprimet me grup hetimor dhe ekspertë kriminalistë.

Struktura e specializuar për luftën kundër drogës ka koordinuar aktivitetet e 12 strukturave vendore, si dhe ka kryer hetime për çështje të rëndësishme, veçanërisht ato që kanë kërkuar bashkëpunim ndërkombëtar. Në mbështetje të strukturave kundër narkotikëve operon edhe personeli i forcës së posaçme të operacioneve speciale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nëpërmjet operacioneve me agjentë nën mbulim dhe mjetet teknike speciale, si dhe me vëzhgim.

Në luftën kundër trafikimit, prodhimit e shitjes së narkotikëve është bashkëpunuar edhe me Prokurorinë e Përgjithshme (në dispozicion të hetimeve është qendra e përgjimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme) në rastet e operacioneve për "dorëzim të kontrolluar", arrestimin e personave në kërkim ndërkombëtar apo për ekzekutimin e "letërporosive" të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja, me Prokurorinë për Krimet e Rënda, për rastet e trafikimit të drogave dhe ndjekjen e grupeve të strukturuara apo organizatave kriminale të trafikut të drogës, si dhe me prokuroritë e rretheve gjyqësore për rastet e veprave të tjera penale në fushën e drogës. Në bazë të urdhrit të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Brendshëm "Për funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore", Policia e Shtetit kryen hetimin e çështjeve penale nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Prokurorisë.

Gjithashtu, në kudër të bashkëpunimit ndërinstitucional është miratuar dhe po zbatohet udhëzimi i përbashkët midis Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Mjedisit nr. 2487, datë 15.5.2017, ku përcaktohet procedura për trajtimin e lëndëve narkotike të sekuestruara nga Policia që nga momenti i kapjes dhe deri në asgjësimin e sigurt të tyre.

Ligji nr. 7975, datë 26.7.1995 "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope", i ndryshuar, ka sanksionuar bashkëpunimin e detyrueshëm mes pushtetit vendor dhe policisë lokale për parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike. Zbatimi i ligjit në praktikë dhe marrja e përgjegjësive nga pushteti vendor dhe policia lokale ka sjellë impakt pozitiv gjatë këtij viti në parandalimin dhe goditjen e kultivimit të bimëve narkotike.

Është bashkëpunuar me strukturat e specializuara për luftën kundër drogës dhe Policisë Kufitare, në drejtim të parandalimit, zbulimit dhe goditjes së aktiviteteve kriminale të lidhura apo të kryera nëpërmjet kufirit shtetëror, ku përfshihet dhe trafikimi i lëndëve narkotike. Për këtë qëllim është miratuar dhe zbatohet urdhri i drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Mbi bashkëpunimin e strukturave të hetimit të departamenteve të Policisë së Shtetit". Në këtë kuadër, Policia Kufitare dhe Migracionit shkëmben informacione me Sektorin e Luftës kundër Drogës, për të pasur nën mbikëqyrje të vazhdueshme personat me precedent kriminal, si dhe për realizimin e operacioneve policore në luftën kundër trafikimit të lëndëve narkotike etj. Gjatë viteve të fundit, si rezultat i këtij bashkëpunimi janë kryer disa operacione të suksesshme ku janë sekuestruar sasi të konsiderueshme lëndë narkotike, si dhe janë arrestuar personat përgjegjës.

Është bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, sidomos në drejtim të kontrolleve me skuadra të përbashkëta në kufi për luftën kundër trafiqeve të paligjshme nëpërmjet përdorimit të përbashkët të pajisjeve, si dhe për kontrollin e prekursorëve. Këtij qëllimi i shërben dhe miratimi i urdhrit të përbashkët të ministrit të Brendshëm, ministrit të Financave dhe ministrit të Bujqësisë, "Për miratimin e rregullores "Për bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit, Shërbimit Doganor, Shërbimit Veterinar dhe Shërbimit Fitosanitar"".

Është bashkëpunuar dhe shkëmbyer informacion me Ministrinë e Shëndetësisë në drejtim të forcimit të masave të kontrollit ndaj prekursorëve dhe lëndëve narkotike që përdoren në mjekësi dhe për këtë qëllim është miratuar dhe një aktmarrëveshje mes dy institucioneve.

Gjithashtu, janë nënshkruar edhe një sërë marrëveshjesh si me autoritetet doganore dhe tatimore, agjenci të regjistrimit të pronës, SHISH-in, Prokurorinë etj., të cilat kanë në thelb shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave, si dhe aksesin në sistemet dhe bazat e të dhënave.

Është miratuar aktmarrëveshja "Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike" midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Koordinimit të Kontrollit të Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, e cila ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit të strukturave të dy institucioneve për të parandaluar, zbuluar dhe luftuar kultivimin e bimëve narkotike në fondin pyjor dhe kullosor në pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Përveç sa më sipër, Policia e Shtetit bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë, në veçanti me Agjencinë e Kontrollit të Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit në drejtim të parandalimit të kultivimit të bimëve narkotike dhe kontrollin e subjekteve që kultivojnë kërp industrial. Për këtë qëllim, është nënshkruar

marrëveshja e bashkëpunimit, si dhe udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Bujqësisë "Mbi kontrollin dhe monitorimin e subjekteve që mbjellin kërp industrial".

Policia e Shtetit dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me qëllim mbështetjen, ndihmën, bashkërendimin dhe shkëmbimin e informacionit për identifikimin, gjetjen dhe ruajtjen e pasurive objekt konfiskimi.

Format e bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me partnerët ndërkombëtarë, që mund të përmendim janë si më poshtë:

- Bashkëpunim për **shkëmbimin e informacionit** me organizatat dhe organizmat ndërkombëtarë, si: UNODC (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin), INCB (Bordi Ndërkombëtar i Kontrollit të Narkotikëve), EMCDDA (Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogat dhe Varësisë nga Drogat), duke shkëmbyer informacione dhe duke plotësuar në kohë pyetësorët dhe detyrime të tjera që rrjedhin në zbatim të konventave ndërkombëtare, si dhe përfitimi prej tyre në trajnime dhe mbështetje logjistike;
- Bashkëpunim në vazhdimësi të informacioneve të ndërsjella me organizata rajonale dhe ndërkombëtare, të krijuar në bazë të marrëveshjeve e protokolleve ku vendi ynë ka aderuar, si: INTERPOL, EUROPOL, SELEC etj.;
- Bashkëpunimi nëpërmjet Drejtorisë së Bashkëpunimit të Koordinimit Ndërkombëtar, Eventeve dhe Protokollit, me oficerët ndërlidhës shqiptarë të atashuar në shtete, si: Romë, Bari/Itali, Kosovë, Turqi, SELEC Bukuresht/Rumani, Athinë/Greqi, Berlin/Gjermani, Paris/Francë, Bruksel/Belgjikë, Londër/Britani e Madhe, SHBA), oficerët ndërlidhës të huaj e asistentët në Tiranë, si dhe oficerët e huaj ndërlidhës të atashuar në vende të tjera, por që mbulojnë Shqipërinë;
- Bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse Italiane "Interforce" dhe zyrën e DEA-s në Athinë.

Gjithashtu, në luftën kundër fenomenit të kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike, Policia e Shtetit ka bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë dhe autoritetet homologe në vende të ndryshme.

Është rritur bashkëpunimi ndërkombëtar jo vetëm në drejtim të shkëmbimit të informacionit me EUROPOL, INTERPOL, organizatat policore partnere, si: SELEC, DEA, oficerët e kontaktit, në zhvillimin e takimeve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë në funksion të procedimeve penale, por edhe më gjerë, në zhvillimin e operacioneve dhe hetimeve paralele të përbashkëta, duke finalizuar me sukses një numër të konsiderueshëm operacionesh ndërkombëtare, si dhe arrestimin e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar për trafikim të lëndëve narkotike.

Po ashtu, vlen të theksohet bashkëpunimi me autoritetet policore italiane, bashkëpunim, i cili gjatë periudhës 2000–2016 çoi në kapjen e 85 tonëve dhe 697 kg lëndëve narkotike.

Bashkëpunim i ngushtë ka qenë edhe me "Misionin Interforza", lidhur me zhvillimin e veprimtarisë së kontrollit të territorit, nëpërmjet monitorimeve ajrore.

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë nuk është kufizuar vetëm me Policinë e Shtetit, por vlen të theksohet edhe roli që kanë luajtur në këtë kontekst edhe organet e tjera ligjzbatuese. Kështu, bashkëpunimi i Shërbimit Informativ Shtetëror me partnerët ndërkombëtarë mbështetet në ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, i ndryshuar me ligjin nr. 9400, datë 12.5.2005, neni 14, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 194, datë 10.4.2004, "Për përparësitë, fushat dhe nivelet e bashkëpunimit me shërbimet partnere". Në këtë kuadër, SHISH-i ka shkëmbyer informacion për trafikun e kanabisit me shërbimet partnere, kosovare, malazeze, italiane, gjermane, britanike dhe Shërbimin Partner Amerikan CIA.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, Prokuroria e Përgjithshme ka konsideruar gjithmonë me rëndësi të veçantë mbajtjen në vazhdimësi të takimeve mujore ndërmjet prokurorëve dhe zyrtarëve të Policisë në nivel qendror dhe lokal në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit të vitit 2013.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar kontakteve të vazhdueshme dhe rritjes së bashkëpunimit me strukturat e policisë në kuadër të ndjekjes penale të veprimtarisë së paligjshme të kultivimit të lëndëve narkotike, ku me anë të qarkores së Prokurorit të Përgjithshëm janë udhëzuar prokurorët në të gjithë vendin për regjistrimin e procedimeve me hetime proaktive dhe mjete të posaçme procedurale, për kërkimin dhe marrjen e provave.

Në kuadrin e rritjes së efektivitetit të hetimit janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi, ku vlen të përmendet marrëveshja e bashkëpunimit "Për shkëmbimin e Informacionit ndërmjet Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes të Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë".

Në kuadër të masave për parandalimin e përgjithshëm të këtij fenomeni, organi i Prokurorisë ka dhënë kontributin e tij të drejtpërdrejtë në hartimin dhe aktualisht në zbatimin e Planit Kombëtar kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit.

Sa i takon bashkëpunimit ndërkombëtar nga institucioni i **Prokurorisë së Përgjithshme** vlen të

theksohet se, bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar për çështjet penale, konkretisht në të gjitha fushat e tij si ekstradime, letëporosi, shpallje në kërkim ndërkombëtar, transferim procedimesh penale dhe personash të dënuar, njohje e vendimeve penale etj., ka pësuar zhvillime të rëndësishme që shprehen në tregues sasiorë dhe cilësorë.

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar në çështjet penale ka ndihmuar veçanërisht në luftën kundër trafiqeve të paligjshme, krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimeve të tjera të rënda.

Prokuroria e Përgjithshme është angazhuar vazhdimisht për hartimin, nënshkrimin ose përditësimin e protokolleve të përbashkëta të bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të rajonit, mund të përmendim: marrëveshjen për bashkëpunim ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë dhe Prokurorisë së Bosnjës e Hercegovinës, në Tiranë, si dhe një sërë memorandumesh bashkëpunimi me disa shtete, si: Rumani, Maqedoni, Bosnjë-Hercegovinë, Mal i Zi, Kroaci, Ukrainë, Kinë, Kosovë, Belgjikë, Turqi, Itali etj.

Në kuadrin e bashkëpunimit, **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** ka bashkëpunuar me Policinë Kufitare në degët doganore, si dhe ka kryer kontrolle të përbashkëta me këtë strukturë. Në bazë të planit operacional, të gjitha strukturat operative operojnë në terren në zonat me risk të lartë, zonat me fluks të lartë me qëllim mbikëqyrjen e të gjithë territorit.

Numri i mjeteve të skanuara gjatë viteve 2015–2016 statistikisht paraqitet si më poshtë:

| Viti | Durrës | Kakavijë | Qafëthanë | Kapshticë | Morinë | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2015** | 24419 | 7660 | 2344 | | | **34423** |
| **2016** | 39009 | 16387 | 44867 | 34868 | 32139 | **167270** |

Në përmbushje të funksioneve të institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka miratuar manualin për procedurat standarde të punës mbi përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe/ose mjeteve të transportit, ku skanimi nga doganat e brendshme bëhet 100% në eksport, si dhe janë përmirësuar profilet e skanimit.

Ky institucion ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTRR), mbi shkëmbimin e informacioneve në kohë reale (*online*) dhe aksesit në sistemet respektive. Aktualisht, është duke u formalizuar marrëveshja për shkëmbimin e informacioneve në kohë reale me SHISH-in.

**Për sa i përket bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë**, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim doganor, konkretisht marrëveshje dypalëshe me administratën doganore kosovare, greke, malazeze, maqedonase dhe italiane në lidhje me kontrollin me vendet kufitare.

Institucion tjetër ligjzbatues, i cili ka pasur një rol të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit është **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave**. Ky institucion ka përqendruar aktivitetin e tij në drejtim të rritjes së efikasitetit të sistemit parandalues përmes bashkëpunimit, jo vetëm me subjektet raportuese të rasteve të dyshimta, institucione të tjera, agjencitë homologe, por edhe me organet ligjzbatuese te të cilat adresohet produkti final i punës së analizës së këtij institucioni. Statistikisht, referimet e realizuara nga kjo strukturë në Policinë e Shtetit dhe Prokurori për periudhën 2010–2016 paraqitet si më poshtë:

| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Referimet në Prokurori | 64 | 51 | 34 | 35 | 148 | 120 | 120 |
| Referimet në Polici | 137 | 160 | 171 | 248 | 314 | 281 | 291 |
| **Totali** | 201 | 211 | 205 | 283 | 462 | 401 | 411 |

Vlen të veçohet bashkëpunimi bashkëpunimi i këtij institucioni me SHISH-in, në kuadër të hetimit të rasteve të dyshuara për financim terrorizmi, ekstremizëm, krim të organizuar, korrupsion dhe shpërdorim detyre. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parasë bashkëpunon me njësitë homologe, anëtare të Grupit EGMONT, në kuadrin e shkëmbimit të inteligjencës financiare. Bashkëpunimi ndërkombëtar me Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF) homologe, përbën një komponent të rëndësishëm të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Informacioni i përcjellë nga homologët, ka qenë mjaft i vlefshëm duke çuar në shumë raste në analiza produktive.

Ky bashkëpunim gjithnjë në rritje ka ardhur duke u intensifikuar sidomos me Njësitë e Inteligjencës Financiare të Britanisë së Madhe, SHBA-së, Italisë, Belgjikës, Holandës, Malit të Zi, Gjermanisë, Francës, Maqedonisë. Përgjigjet ndaj kërkesave të homologëve dërgohen në kohë, duke moskrijuar kështu asnjë pengesë në komunikim apo në mbarëvajtjen e rasteve.

Gjithashtu, nuk ka munguar asnjëherë bashkëpunimi në kohë reale nga ana e homologëve për çdo

informacion të kërkuar nga Njësia e Inteligjencës Financiare shqiptare. Shkëmbimi i informacionit me strukturat homologe për periudhën 2010–2016, nga ana statistikore, paraqitet si më poshtë:

| Vitet | Shkresa | | Përgjigje | |
|---|---|---|---|---|
| | Të dërguara nga DPPPP-ja | Të marra nga homologët | Të dërguara nga DPPPP-ja | Të marra nga homologët |
| **2016** | 42 | 76 | 42 | 33 |
| **2015** | 58 | 77 | 63 | 50 |
| **2014** | 66 | 62 | 48 | 47 |
| **2013** | 35 | 56 | 70 | 28 |
| **2012** | 38 | 50 | 40 | 18 |
| **2011** | 54 | 69 | 59 | 55 |
| **2010** | 100 | 42 | 25 | 172 |

***Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar gjithsesi mbetet një sfidë*** në nivel qendror, lokal dhe ndërkombëtar dhe konsiderohet si një ndër problemet dhe sfidat kryesore që qëndrojnë pas përmasave dhe shtrirjes së dukurisë së kultivimit.

Si aspektet më të rëndësishme në këtë fushë renditen:

- Mangësitë në koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet ministrive të linjës dhe ndërmjet institucioneve e agjencive të tjera me përgjegjësi në këtë fushë;
- Pamjaftueshmëria e strukturave të dedikuara për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional në nivel qendror dhe lokal;
- Mungesa e bashkëpunimit me përfaqësuesit e organeve të vetëqeverisjes vendore dhe strukturat përkatëse në bashki;
- Mungesa e fondeve nga buxheti i shtetit dhe buxheti vendor, për zbatimin e projekteve sociale, për arsimin, bujqësinë, pyjet, blegtorinë etj., në zonat ku mbillet kanabis;
- Orientimi i kufizuar i projekteve sociale, kulturore, arsimore e bujqësore drejt zonave të prekura;
- Niveli i ulët në shkëmbimin reciprok të informacionit midis strukturave përgjegjëse në nivel vendor;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i institucionit të prefektit në rolin koordinues midis institucioneve në nivel vendor;
- Pamjaftueshmëria e programeve të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë.

**2.7 Ndërgjegjësimi publik dhe fushata informuese**

Në kuadër të ndërgjegjësimit të komunitetit, ndër vite nga strukturat e Policisë së Shtetit janë zhvilluar takime sensibilizuese sipas plan-kalendarit në nivel lokal, me qëllim informimin e publikut, rritjen e përgjegjshmërisë së qytetarëve në lidhje me dëmet që shkakton kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike.

Pavarësisht për sa më sipër, si problematikat më kryesore në fushën e ndërgjegjësimit konsiderohen:

- Pamjaftueshmëria e fushatave të ndërgjegjësimit për dëmet dhe pasojat e lidhura me kultivimin;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i njësive vendore mbi ndërgjegjësimin dhe orientimin e fermerëve drejt kultivimit të kulturave bujqësore apo prodhimeve blegtorale të ligjshme, të qëndrueshme e fitimprurëse;
- Mosofrimi i mundësive të përshtatshme nga platformat ekzistuese të raportimit për qytetarët që duan të sinjalizojnë rastet e kultivimit apo trafikimit të lëndëve narkotike.

## KAPITULLI II
## MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

**1. Vizioni**

Për një Shqipëri të çliruar nga bimët narkotike, ku dinjiteti, mirëqenia dhe siguria e qytetarëve bazohen te puna e ndershme dhe respekti ndaj ligjit.

**2. Misioni**

Goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe krijimi i mundësive për zhvillim të qëndrueshëm në komunitetet dhe zonat e prekura.

Synimi i këtij plani është të krijojë kushtet për zbatimin efektiv të dokumenteve që adresojnë kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, duke u fokusuar në krijimin e instrumenteve efikase dhe marrjen e masave të nevojshme.

**3. Metodologjia**

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 170, datë 23.11.2016, është ngritur grupi i ekspertëve nga të gjitha institucionet përgjegjëse për hartimin e dokumentit strategjik. Hartimi i Planit të Veprimit është mbështetur nga ekspertë vendës, si dhe ekspertë ndërkombëtarë të: *Technical Assistance and Information Exchange Instrument on European Commission (TAIEX), Organisation for Security and Co-operation in Europe (OSCE), International*

*Criminal Investigative Training Assistance Program (ICITAP), Police Assistance Mission of the European Community to Albania (PAMECA IV)* etj.

Përveç grupit të ekspertëve, në këtë proces është përfshirë edhe një grup ndërministror nën drejtimin e zëvendëskryeministrit dhe me pjesëmarrjen e ministrave kryesorë të linjës. Grupi ndërministror ka mbajtur kontakte të rregullta edhe me ambasadorët e akredituar në Shqipëri, si dhe me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare të pranishme në Shqipëri.

Në vijim të takimeve dhe konsultimeve, grupi ndërministror në bashkëpunim me ekspertët, hartuan Planin e Veprimit kundër kanabisit, në vijim i miratuar me vendimin nr. 248, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të Planit u miratua urdhri i Kryeministrit nr. 51, datë 17.4.2017, në bazë të të cilit është ngritur Komiteti Ndërinstitucional dhe Task-Forca Qendrore, të ngarkuar me zbatimin e masave të përcaktuara në Planin e Veprimit. Komiteti ndërinstitucional (KN) në përbërje të tij ka anëtarë të kabinetit qeveritar (ministra) dhe kryesohet nga zëvendëskryeministri, ndërsa Task–Forca Qendrore (TFQ) përbëhet nga përfaqësues të lartë në nivel drejtori në ministri dhe institucione të tjera ligjzbatuese dhe drejtohet nga zëvendësministri i brendshëm.

Gjithashtu, në zbatim të urdhrit të sipërcituar janë ngritur 12 task-forca vendore (TFV), të cilat përbëhen nga përfaqësues në nivel lokal të institucioneve shtetërore dhe organeve ligjzbatuese dhe drejtohen nga prefektët përkatës.

Gjatë veprimtarisë së saj, TFQ-ja konstatoi disa problematika lidhur në veçanti me zbatimin konkret të objektivave/masave të Planit të Veprimit 2017–2020. Ndër më kryesoret, vlen të theksohet, mosplanifikimi i efekteve financiare për mbulimin e shpenzimeve që sjell zbatimi i masave, mospërcaktimi i duhur i masave për institucionet përkatëse, formulim jo i duhur i terminologjisë së fushës, ndryshimet strukturore të qeverisë dhe fushës së përgjegjësisë së ministrive, reflektimi jo i plotë i rekomandimeve të lëna nga ekspertët e TAIEX në muajin janar të vitit 2017 etj.

Në këtë kontekst, gjatë takimeve periodike mujore të zhvilluara ndërmjet anëtarëve të TFQ-së, u dakordësua nevoja e rishikimit të planit aktual dhe për këtë qëllim u ofrua asistencë nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri nëpërmjet TAIEX.

Gjatë periudhës shtator–dhjetor 2017, u zhvilluan tri misione me ekspertët e TAIEX, të cilët u informuan mbi gjendjen aktuale, veprimtarinë e task-forcës, treguesit, si dhe problematikat e hasura gjatë vitit 2017. Në përfundim të çdo misioni, ekspertët përcollën rekomandimet të cilat janë marrë në shqyrtim dhe reflektuar në këtë dokument.

**4. Objektiva strategjikë**

Objektivat kryesorë të PKKK-së, janë: parandalimi dhe reduktimi i kultivimit, goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të trafikimit, reduktimi dhe shkurajimi i përdorimit të kanabisit, bashkëpunimi, koordinimi dhe forcimi i kapaciteteve, si dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe zhvillimi i projekteve.

**4.1 A) Parandalimi dhe reduktimi i kultivimit dhe trafikimit të kanabisit**

Objektivi i parë për t'u arritur është parandalimi, goditja dhe reduktimi i prodhimit të kanabisit. Përmbushja e këtij objektivi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e objektivave të tjerë dhe realizmi i këtij objektivi do të kryhet me një kombinim masash, të cilat prekin jo vetëm kultivimin, por të gjithë ciklin, përfshirë dhe të përdorimit e trafikimit të lëndëve narkotike.

Synohet të parandalohet dhe të shkatërrohet cikli i kultivimit që në fillesën e tij, duke mbajtur në kontroll të rreptë të gjithë elementët e tij, si: aktivizimi i burimeve financiare, rekrutimi i fuqisë punëtore, sigurimi i farërave dhe fidanëve, hapja apo punimi i tokave, ndërtimi i impianteve të ujitjes etj.

Në fazën e parë të ciklit, do të mbahet nën monitorim të fortë dhe goditet me efikasitet të lartë procesi i sigurimit të farërave, si dhe i prodhimit të fidanëve. Pavarësisht se në këtë fazë fenomeni është i vështirë të zbulohet, ai është shumë i lehtë për t'u goditur. Kultivimi fillestar i fidanëve në mjedise të mbyllura dhe në sipërfaqe të vogla, konsiderohet një fazë, gjatë së cilës sigurimi i informacionit është shumë i rëndësishëm. Strukturat e shërbimeve të inteligjencës, luftës kundër krimit, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FA), bujqësisë, pyjeve, doganave, tatimeve, si dhe ato të pushtetit vendor dhe veçanërisht qytetarët do të luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e informacionit të nevojshëm për goditjen e veprimtarisë kriminale.

Plani i Veprimit orienton që i gjithë reagimi institucional të përqendrohet në këtë fazë, pasi goditja e hershme e dukurisë, siguron rezultate të dukshme dhe të shpejta, duke parandaluar përhapjen e tij në territorin e vendit. Një qasje e tillë kursen edhe energjitë e mëdha që kërkohen për të goditur fenomenin kur ai ka dalë nga mjediset e mbyllura dhe sipërfaqet e vogla dhe është përhapur në zona të thella. Goditja e hershme parandalon, gjithashtu, kriminalizimin e qytetarëve që përfshihen në procesin e kultivimit në sipërfaqe të hapura.

Objektiva specifikë për parandalimin dhe goditjen e kultivimit, janë:

1. Goditja e financave të grupeve kriminale duke shënjestruar, verifikuar, hetuar, sekuestruar dhe konfiskuar pasuritë dhe asetet e krijuara nga aktiviteti kriminal, duke u mbështetur veçanërisht në dispozitat ligjore që parashikon ligji "Antimafia"[4];

2. Kontrolli efikas i territorit, nëpërmjet angazhimit të koordinuar të të gjitha strukturave përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor të vetëqeverisjes;

3. Krijimi i hartave të sipërfaqeve të tokave, pyjeve e kullotave, ku janë kultivuar ose potencialisht mund të kultivohen bimë narkotike. Për krijimin e këtyre hartave, të bazuara në evidencën historike të kultivimit dhe në mundësitë që lidhen më klimën, gjeografinë dhe përbërjen e tokës, do të angazhohen strukturat përgjegjëse të bujqësisë, të mjedisit, vetëqeverisjes vendore, inteligjencës dhe policisë;

4. Përfshirja e gjerë e publikut në procesin e informimit kundër kultivimit të bimëve narkotike nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe krijimi i mundësive praktike për sigurimin e informacionit nga qytetarët;

5. Shkurajimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në kultivimin e bimëve narkotike nëpërmjet zbatimit të kombinuar të masave shtrënguese ligjore, krijimit të hapësirave për veprimtari të ligjshme dhe realizimit të programeve të nevojshme sociale, arsimit, bujqësisë, pyjeve, blegtorisë etj.;

6. Diferencimi dhe proporcionaliteti i dënimeve penale në bazë të roleve të subjekteve në veprimtarinë kriminale;

7. Forcimi i kapaciteteve të njësive të specializuara për luftën kundër drogës nëpërmjet trajnimit e pajisjes së tyre me mjetet e nevojshme;

8. Forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të farave/fidanëve të kanabisit dhe drogave;

9. Rishikimi i kritereve dhe përforcimi i kontrolleve ndaj integritetit dhe personalitetit të zyrtarëve shtetërorë të ngarkuar me detyra në fushën e narkotikëve, të të gjitha niveleve, me qëllim verifikimin e plotë të gjithë zyrtarëve të angazhuar kundër fenomenit. Analiza e sukseseve dhe e problemeve të evidentuara gjatë ushtrimit të detyrës, pasuria, lidhjet eventuale me persona të inkriminuar, kapacitetet profesionale, familjarizimi me gjendjen problematike janë kritere ku do të bazohet kontrolli;

10. Angazhimi i drejtpërdrejtë i drejtorive të bujqësisë, mjedisit dhe pyjeve në nivel vendor dhe strukturave përkatëse në bashki, për evidentimin e sipërfaqeve të mundshme për t'u mbjellë, të dyshuara për një veprimtari të tillë apo të mbjella me bimë narkotike, si dhe raportimi në mënyrë të vazhdueshme për gjendjen e sipërfaqeve që janë nën përgjegjësinë e tyre;

11. Përmirësimi dhe fuqizimi i kapaciteteve, si dhe ngritja e një laboratori për analizën e përmbajtjes së *cannabidiolit, cannabionolit* dhe *tetrahidrocannabinolit (THC)*;

12. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me administratat rajonale të zonave të mbrojtura në qarqe për evidentimin dhe identifikimin e këtyre zonave, të cilat mund të cilësohen si problematike dhe potencial për kultivimin e këtyre lëndëve narkotike;

13. Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes së zonave të thella rurale brenda zonave të mbrojtura nga ana e administratave rajonale të ZM-ve, si dhe bashkëpunimi në kohë reale me Policinë e Shtetit;

14. Bashkëpunimi për përditësimin e hartave që përpunohen, për zonat e mbjella me kanabis, për më tepër për zonat e thella rurale.

**Goditja dhe shkatërrimi i rrjeteve të trafikimit**

Goditja e vendosur dhe shkatërrimi i rrjeteve kriminale, të përfshira në trafikimin e lëndëve narkotike është objektivi më i rëndësishëm strategjik i këtij plani. Ky objektiv përbën dhe gurin themeltar të luftës kundër kanabisit. Përmbushja me sukses e tij ndikon në përmbushjen me sukses dhe të objektivave të tjerë. Nëpërmjet tij synohet që të shtohen dhe identifikohen masat shtrënguese dhe goditëse ligjore nga të gjitha drejtimet dhe në të gjitha nivelet.

Objektiva specifikë për goditjen dhe shkatërrimin e trafikimit janë si më poshtë:

1. Rritja e vigjilencës dhe shtimi i kapaciteteve të strukturave doganore, tatimore dhe të inteligjencës financiare për një kontroll më rigoroz për parandalimin e trafikimit të lëndëve narkotike;

2. Bashkëpunimi i hershëm i shërbimeve inteligjente dhe policore me strukturat homologe të vendeve të origjinës së farërave;

3. Përmirësimi dhe intensifikimi i kontrollit kufitar nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse për kufirin, shtimit të kapaciteteve të skanimit, rishikimit të kritereve të përcaktimit të riskut dhe kontrollit elektronik e fizik;

4. Përmirësimi i procedurave për kontrollin e qarkullimit të parasë në pikat kufitare;

---

[4] Ligj nr. 10192, datë 3.12.2009.

5. Vlerësimi ndërinstitucional i riskut për mjetet e transportit në pikat kufitare, nëpërmjet përfshirjes në këtë proces të të gjithë aktorëve shtetërorë përgjegjës. Përfshirja e strukturave doganore, tatimore, policore, bujqësore, mjedisore dhe atyre të inteligjencës në vlerësimin e riskut në transportin tokësor, detar dhe ajror ndërkombëtar, si dhe shtimi i konsiderueshëm i kapaciteteve dhe i frekuencës së kontrolleve fizike dhe skanimit;

6. Rritja e kapaciteteve operacionale njerëzore, logjistike dhe financiare i të gjitha strukturave qendrore dhe vendore të angazhuara kundër kultivimit, përdorimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike;

7. Shtimi i kapaciteteve njerëzore të strukturave të ngarkuara me kontrollin e territorit, nëpërmjet përforcimit dhe mbështetjes së kapaciteteve policore edhe nga strukturat ushtarake, të angazhuara në kontrollin e territorit në përputhje me përcaktimet përkatëse ligjore;

8. Rritja e kapaciteteve teknike të Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera kryesisht me automjete të kalueshmërisë së lartë, mjete zbulimi në distanca të largëta për ditën dhe natën;

9. Angazhimi i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në fushën e inspektimit të tregut të farave dhe fidanëve për parandalimin e trafikimit të farërave;

10. Krijimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të specializuara të vëzhgimit satelitor ajror dhe detar për rritjen dhe përmirësimin e kontrollin e territorit;

11. Bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë për fuqizimin e kontrollit kufitar dhe atij të territorit nëpërmjet zgjerimit të partneriteteve ekzistuese (marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe);

12. Shtimi i përgjegjësisë dhe i kapaciteteve të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (SIVHD) për përmirësimin e monitorimit të hapësirës detare dhe shkëmbimin e informacionit;

13. Forcimi i koordinimit ndërinstitucional (përfshirja e të gjitha institucioneve dhe aktorëve të tjerë) për goditjen e trafikut e shpërndarjes së lëndëve narkotike, si dhe sekuestrimin e aseteve kriminale;

14. Fokusimi në rritjen e eficiencës së hetimeve, nëpërmjet përdorimit të metodave speciale të hetimit;

15. Zgjerimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për kryerjen e operacioneve policore, si dhe hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare;

16. Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të strukturave të specializuara për luftën kundër drogës nëpërmjet pajisjes së tyre me mjetet dhe pajisjet e nevojshme;

17. Përmirësimi i legjislacionit në fushën e drogës, rishikimit të aspekteve të ndryshme të legjislacionit kombëtar, me synim përmirësimin e mëtejshëm të tij në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së në këtë fushë (ndryshime në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 8750, 26.3.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope");

18. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve në fushën e uljes së ofertës për drogë.

**4.2 B) Reduktimi dhe shkurajimi i përdorimit të kanabisit**

Objektivi i tretë madhor kundër fenomenit të kanabisit mbetet reduktimi i përdorimit të tij kryesisht nëpërmjet programeve informuese, ndërgjegjësuese dhe edukuese, duke shënjuar grupet më të ekspozuara ndaj këtij fenomeni. Përgjigjja me masa konkrete ndaj shtimit të ofertës së drogave në shkolla, përbën një sfidë, jo vetëm për institucionet shtetërore, por edhe për të gjithë shoqërinë shqiptare për të mbrojtur grup-moshat më delikate.

Objektiva specifikë për reduktimin e përdorimit të kanabisit, janë:

1. Zgjerimi i programeve të informimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit parandalues ndaj përdorimit të lëndëve narkotike në të gjithë sistemin shkollor parauniversitar, duke filluar që nga klasa e pestë;

2. Përforcimi i kontrolleve në shkolla, konvikte, qendra sociale dhe mjedise publike me frekuentim të lartë nga rinia;

3. Përforcimi i strukturave publike ambulatore, shërbimeve ditore dhe shërbimeve komunitare për trajtimin e problemeve të drogave;

4. Ngritja e strukturave të specializuara për trajtimin e përdoruesve të substancave narkotike dhe përmirësimi i furnizimit me barna;

5. Forcimi i shërbimeve sociale të specializuara për riintegrimin në shoqëri të personave, të cilët janë trajtuar nga shërbimet përkatëse;

6. Krijimi i një sistemi kualifikimi dhe shtimi i personelit të specializuar për trajtimin e problematikave të drogave dhe atyre të varësisë;

7. Ndërhyrje ligjore që brenda kësaj kategorie të diferencohen fëmijët, ndaj të cilëve duhet të veprojnë mekanizma mbrojtës. Rastet e tyre duhet të konsiderohen si raste të punës së fëmijëve dhe të trajtohen nga mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve. Përfshirja e fëmijëve, sidomos atyre nën moshën 16 vjeç duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese në caktimin e dënimit për trafikantët.

**4.3 C) Bashkëpunimi, koordinimi dhe forcimi i kapaciteteve**

Në krye të përpjekjes shtetërore për parandalimin dhe goditjen e kultivimit, përdorimit dhe trafikimit të

lëndëve narkotike është Komiteti Ndërinstitucional (KN) me pjesëmarrjen e ministrave dhe zyrtarëve të tjerë të lartë. Misioni i këtij komiteti është miratimi i politikave dhe i vendimeve të rëndësishme, përcaktimi i përparësive, akordimi i burimeve financiare dhe materiale, si dhe drejtimi i veprimtarisë së Task-Forcës Qendrore (TFQ).

Organizimi dhe funksionimi i Komitetit Ndërinstitucional paraqitet si më poshtë:

*Skema 1. Organizimi dhe funksionimi i KN-së*




*Skema 2. Struktura e Komitetit Ndërinstitucional*




TFQ-ja është një strukturë operacionale në nivel qendror e cila koordinon, orienton dhe kontrollon veprimtarinë e strukturave qendrore dhe vendore të ngarkuara me zbatimin e këtij plani. TFQ-ja funksionon përgjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së këtij plani.

Detyrat e TFQ-së përfshijnë koordinimin operacional në nivel qendror, analizat e përbashkëta të gjendjes, matjen dhe vlerësimin e suksesit të strukturave të ngarkuara me zbatimit të këtij plani, si dhe mbështetjen e tyre me mjetet e nevojshme. Në përbërje të TFQ-së janë përfaqësues të Policisë së Shtetit, Prokurorisë, Shërbimit Informativ të Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorisë së Hetimit Doganor, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe strukturave të tjera që kanë detyrime në kuadër të këtij plani.

*Skema 3. Struktura e Task-Forcës Qendrore*




Në nivel vendor janë ngritur dhe funksionojnë Task-Forcat Vendore (TFV) në përbërje të të cilave janë përfaqësues në nivel vendor të institucioneve të përfaqësuara në TFQ, përfaqësues të institucionit të Prefektit të qarkut dhe pushtetit vendor.

Krijimi i një fondi qeveritar për të financuar programet mbështetëse për banorët e zonave rurale të rrezikuara nga përfshirja në veprimtari të paligjshme është instrumenti që mundëson jetësimin e objektivave

të kësaj strategjie. Fondi të krijohet nga kontributi i qeverisë, i autoriteteve vendore dhe i donatorëve.

*Skema 4. Struktura e Task-Forcave Vendore*




**4.4 D) Ndërgjegjësimi publik dhe zhvillimi i projekteve**

Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut rreth rreziqeve, dëmeve dhe pasojave individuale, familjare dhe shoqërore që sjell indiferenca apo përfshirja në veprimtaritë kriminale të përdorimit, kultivimit apo trafikimit të lëndëve narkotike është një objektiv i rëndësishëm i këtij plani.

Përdorimi i kombinuar i medieve tradicionale dhe bashkëkohore në një proces të mirorganizuar për informimin publik është një mjet i rëndësishëm për ndërgjegjësimin e shoqërisë. Krahas përdorimit të medieve tradicionale, rëndësi të veçantë ka përdorimi i medieve bashkëkohore si mjete të përshtatshme për të përcjellë informacionin te të rinjtë, me qëllim mbajtjen e tyre larg kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të lëndëve narkotike.

Mediet të përdoren jo vetëm, si mjete për të përcjellë informacione të dobishme për informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin publik, por edhe për sigurimin e informacioneve nga qytetarët për goditjen e fenomenit.

Portale të dedikuara të ofrojnë informacione dhe programe edukimi kundër lëndëve narkotike, me qëllim që të rinjtë të gjejnë informacion të dobishëm për t'u mbrojtur nga efektet dhe pasojat e përdorimit të tyre.

Nëpërmjet medieve të inkurajohet angazhimi në fushatat e ndërgjegjësimit, informimit dhe edukimit i zërave të rëndësishëm publikë dhe i ekspertëve të edukimit, shëndetësisë, artit, sportit, policisë etj.

Rritja e pranisë së policisë në rrjetet dhe mediet sociale është një masë e rëndësishme, përmes së cilës do të rriten mundësitë e komunikimit të saj me qytetarët dhe veçanërisht me të rinjtë.

## KAPITULLI III
## PLANI I VEPRIMIT

Objektivi strategjik A: Parandalimi dhe reduktimi i kultivimit dhe trafikimit të kanabisit

Masa A.1: Identifikimi i objekteve/i vendeve dhe sipërfaqeve me risk për kultivimin dhe trafikimin e

kanabisit, si dhe hartimi i hartave të sipërfaqeve potenciale që janë mbjellë në vite me kanabis

**Qëllimi**

Identifikimi i sipërfaqeve të mbjella me kanabis dhe atyre potenciale për t'u mbjellë.

**Përshkrim i shkurtër**

Bimët kanabis, kultivohen kryesisht në pyje dhe kullota të largëta në pronësi publike të shtetit (MTM-ja për pyjet dhe kullotat në zonat e mbrojtura) dhe të bashkive (për pyjet e transferuara në pronësi). Sipas vlerësimeve aktuale, rreth 20 mijë ha tokë konsiderohet si sipërfaqe potenciale që mund të përdoret për kultivimin e kanabisit.[5]

Për të mundësuar identifikimin e sipërfaqeve të tilla të merret kjo masë:

- MBZHR-ja të krijojë hartën sipas zonave me risk për kultivimin e kanabisit në tokat disponibël shtetërore me origjinë nga ish-NB, në bashkëpunim me ASIG-un.

**Rezultate të pritshme**

- Krijimi i hartës;
- Përditësimi periodik i hartës.

**Institucionet përgjegjëse**

- MBZHR-ja;
- PSH-ja.

**Institucione të tjera**

- Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit, Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale;
- MTM-ja;
- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Drejtoritë/sektorët e pyjeve dhe kullotave në bashki, zyrat e kadastrës;
- Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në qarqe;
- Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë.

**Indikatorë të matshëm**

Numri/shpeshtësia e përditësimeve;

Sipërfaqja e tokave të hartëzuara.

Masa A.2: Dhënia me qira e pronave publike për përdorim privat të ligjshëm.

**Qëllimi**

Shtimi i sipërfaqes së mbjellë me bimë bujqësore që përshtaten me kushtet e zonave të riskuara, zgjerimi i aktiviteteve të tjera të ligjshme dhe rritja e numrit të të punësuarve, duke zvogëluar njëkohësisht mundësinë e shfrytëzimit të tyre për qëllime kriminale.

**Përshkrim i shkurtër**

Kultivimi i bimëve narkotike është kryer kryesisht në toka në pronësi publike, toka joproduktive, toka në pronësi të fermerëve larg zonave të banuara, si dhe në pyje e kullota. Për të reduktuar mundësinë e keqpërdorimit të aseteve publike, tokat dhe asetet e tjera publike të lira, t'u jepen në përdorim banorëve të zonave rurale të riskuara, kundrejt skemave favorizuese (kultivim me bimë medicinale të përshtatshme për këto kategori tokash etj.). Kjo masë synon të shtojë sipërfaqet e tokës, të pyjeve dhe kullotave dhe aseteve të tjera në disponim të fermerëve dhe familjeve në nevojë, duke u siguruar atyre mundësi shtesë për punë të ndershme.

Për mundësimin e dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi pronave publike të merren këto masa:

1. Të kryhet rishikimi i ligjeve që parashikojnë qiramarrjen e tokës[6];

---

[5] Në vend ka gjithsej 696 000 ha, prej të cilave janë privatizuar si tokë bujqësore 560 000 ha. 136.000 ha janë toka të pandara në administrim publik.

Sipërfaqe që mbillet me bimë arash dhe pemëtari është rreth 500.000 ha.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore të privatizuar që nuk kultivohet është rreth 60.000 ha, prej së cilës rreth 25 000 ha është joproduktive, 15 000 ha preket nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, autostradat, ndërtimi i HECE-ve dhe projekteve të tjera. Nga sipërfaqja totale, rreth 20 000 ha mbeten potencialisht të mundur për t'u kultivuar.

[6] Aktualisht ekziston baza ligjore për dhënien me qira të tokave, si:

1. Ligji nr. 8318, datë 1.4.1998, "Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar.

2. Udhëzim nr. 1, datë 18.7.2012, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara".

3. VKM nr. 460, datë 22.5.2013, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit".

4. Udhëzimi i ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 6, datë 5.6.2013, "Për kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e përllogaritjes së kritereve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit".

2. Të ndërgjegjësohen dhe nxiten qytetarët për mundësinë e marrjes me qira të pronave publike;

3. Të krijohen lehtësira ligjore/financiare për nxitjen e qiramarrjes së tokës nga ana e fermerëve;

4. Të angazhohen strukturat e administrimit të tokës, të konsulencës për bujqësinë dhe blegtorinë, të administrimit të pyjeve dhe kullotave në bashki për lehtësimin e procesit të qiramarrjes;

5. Të kryhet inventarizimi i plotë i tuneleve dhe strehimeve nëntokësore, që janë jashtë planit të përhapjes dhe vendosjes së FA-së dhe të bëhet administrimi i tyre përmes dhënies në përdorim/qira.

**Rezultate të pritshme**

- Shtimi i përfituesve të qiramarrjes të aseteve publike;
- Shtimi i sipërfaqes së tokës të marrë me qira;
- Rritja e numrit të personave të vetëpunësuar/punësuar në zonat e riskuara.

**Institucion përgjegjës**

- MBZHR-ja.

**Institucione të tjera**

- Organet e vetëqeverisjes vendore;
- Ministria e Mbrojtjes (MM);
- Ministria e Drejtësisë (MD).

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i përfituesve të qiramarrjes;
- Sasia e sipërfaqes së tokës të marrë me qira (ha);
- Numri i personave të punësuar/vetëpunësuar;
- Masa A.3 Përmirësimi i menaxhimit të kufijve për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të kanabisit, farave dhe mjeteve/pajisjeve të tjera që i shërbejnë kësaj veprimtarie kriminale.

**Qëllimi**

- Shtimi i kapaciteteve të kontrollit të kufirit për të parandaluar trafikimin e lëndëve narkotike;
- Intensifikimi i kontrolleve policore dhe doganore, për zbulimin e narkotikëve, përfshirë dhe farërat e kanabisit;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me vendet e origjinës së farërave dhe destinacionit të narkotikëve;
- Adaptimi i një qasjeje specifike (zbulimi, teknikat, taktikat dhe procedurat) për luftën ndaj kontrabandës.

**Përshkrim i shkurtër**

Menaxhimi efektiv i kufijve është një kusht i rëndësishëm për suksesin kundër trafikimit të kanabisit. Suksesi në menaxhimin e kufijve lidhet ngushtë me përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional mes strukturave që kanë përgjegjësi në kontrollin e tyre, si dhe me zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Rritja e kontrolleve dhe kapaciteteve përkatëse është një ndër prioritetet e këtij plani.

Për përmirësimin e menaxhimit të kufijve të merren këto masa:

1. Të krijohen mekanizma bashkëpunimi dhe shkëmbimi ndërkufitar të informacionit me Italinë, Greqinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë, si: qendra dypalëshe, pika të përbashkëta kufitare, patrullime dhe operacione të përbashkëta kundër trafikut;

2. Të zgjerohet bashkëpunimi me strukturat ndërkombëtare, si: INTERPOL, EUROPOL, EMCDDA, në funksion të parandalimit dhe goditjes së trafikut ndërkombëtar;

3. Të hartohen dhe miratohen procedura standarde të veprimit mes PSH-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), autoriteteve portuale dhe aeroportuale, si dhe të kontrollit fito-sanitar, me qëllim kryerjen e kontrolleve të përbashkëta;

4. Të krijohen kapacitete teknike e njerëzore për zbatimin e procedurave ligjore në pikat doganore për importimin e farave të bimëve bujqësore, për parandalimin e futjes në tregun e vendit tonë të farave të kanabisit;

5. Të kombinohen kontrollet fizike me metodat speciale të hetimit në pikat kufitare;

6. Të vendosen oficerë ndërlidhës me partnerët kryesorë;

7. Të sigurohet pjesëmarrja e Policisë Kufitare në njësitë e përbashkëta vendore kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit;

8. Të rritet dhe të përmirësohet kontrolli kufitar detar, përmes Rojës Bregdetare, SIVHD-së, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare;

9. Të rritet dhe përmirësohet kontrolli i kufirit tokësor, përmes rritjes së kapaciteteve ajrore;

10. Ndryshimi i strukturës organizative të DPD-së duke vënë theksin në drejtim të rritjes së sigurisë;

11. Të riorganizohet Drejtoria e Hetimit Doganor, duke krijuar sektorë të posaçëm për hetimin dhe koordinimin me struktura të tjera për mashtrimet fiskale, për hetimin e çështjeve të sigurisë, sektorin e analizës dhe raportimit, si dhe krijimin e task-forcës me oficerë të Policisë Gjyqësore;

12. Fuqizimi i strukturave kontrolluese pranë Degës Doganore Durrës, ku është krijuar për herë të parë sektori i kontrollit të sigurisë, që do të ketë në përbërje zyrën e kontrollit, të eksporteve, skanerit dhe të kontrollit të bagazheve;

13. Ndryshimi i strukturës së Drejtorisë Antitrafik, duke u riorganizuar në sektorë specifikë, si sektori i kontrollit të deklarimit të parave (*CASH*), sektori i ndjekjes së mallrave të rrezikshme, *Dual Use*, trafiqeve të paligjshme, sektori operativ antitrafik.

**Rezultate të pritshme**

- Rritja e numrit të veprimeve të përbashkëta hetimore dhe operacionale me partnerët ndërkombëtarë;
- Rritja e kapaciteteve të skanimit të mjeteve në pikat e kalimit të kufirit;
- Lista e personave të arrestuar në pikat kufitare për vepra penale të lidhura me drogën;
- Sasia e drogës me origjinë nga Shqipëria, e konfiskuar në vendet fqinje;
- Raporte mbi mënyrën e kalimit të farërave të kanabisit në kufi, nga vendi i origjinës.

**Institucioni përgjegjës**

- PSH-ja.

**Institucione të tjera**

- MFE-ja;
- DPD-ja;
- PP-ja;
- MM-ja;
- SHISH-i;
- Partnerë ndërkombëtarë.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i veprimeve/i operacioneve hetimore të kryera në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë;
- Sasia e automjeteve të skanuara në pikën kufitare;
- Numri i personave të kapur në pikat kufitare për drogë;
- Sasia e drogës me origjinë nga Shqipëria e konfiskuar në vendet fqinje.

Masa A.4: Rritja e efektivitetit të burimeve për mbledhjen e informacionit dhe rritja e hetimeve - proaktive për parandalimin dhe goditjen e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit

**Qëllimi**

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve me qëllim kryerjen e hetimeve proaktive për parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

**Përshkrim i shkurtër**

Për arritjen e suksesit në këtë fazë, të merren këto masa:

- Kryerja e trajnimeve me qëllim shkëmbimin e eksperiencave mbi tendencën e kultivimit të kanabisit në ambiente të mbyllura;
- Kryerja e trajnimeve për prokurorë me qëllim marrjen e eksperiencave në metodat dhe teknikat e hetimore nga vendet anëtare të BE-së, për përdorimin e metodave speciale të hetimit, agjent i infiltruar, blerje e simuluar, dorëzim i kontrolluar për hetimin e kultivimit/prodhimit/trafikimit të kanabisit.

**Rezultate të pritshme**

- Përmirësimi i hetimeve proaktive, me qëllim kapjen dhe vënien në përgjegjësi të sa më shumë autorëve të kryerjes së veprës penale, apo edhe organizatave kriminale, grupeve të strukturuara.

**Institucioni përgjegjës**

- MB-ja/PSH-ja.

**Institucione të tjera**

- Institucione të tjera të TFQ-së.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i trajnimeve të zhvilluara;
- Numri i hetimeve proaktive;
- Numri i autorëve të identifikuar;
- Numri i organizatave kriminale;
- Numri i grupeve të strukturuara kriminale;
- Masa A.5: Goditja e kultivimit që në fazat e hershme të ciklit.

**Qëllimi**

Përqendrimi i përpjekjeve kryesore te parandalimi i mbjelljes dhe shkatërrimi i fidanëve.

**Përshkrim i shkurtër**

Kultivimi paraprak i fidanëve në mjedise të mbyllura dhe në sipërfaqe të vogla konsiderohet si një fazë gjatë së cilës merr rëndësi të veçantë gjetja e informacionit të nevojshëm. Strukturat e shërbimeve informative, të luftës kundër krimit, FA-së, bujqësisë, pyjeve, doganave, tatimeve, ato të pushtetit vendor dhe posaçërisht qytetarët do të luajnë rol të rëndësishëm në informimin e strukturave ligjzbatuese, të ngarkuara me goditjen e veprimtarisë kriminale. Ky plan synon përqendrimin e reagimit institucional në këtë fazë, pasi duke e goditur herët fenomenin, parandalohet përhapja e tij në territor. Goditja e hershme parandalon, gjithashtu, kriminalizimin e qytetarëve që përfshihen në procesin e kultivimit në sipërfaqe të hapura.

Për arritjen e suksesit në këtë fazë, të merren këto masa:

1. Të ushtrohet kontroll rigoroz i rrugëve të importit dhe pikave të shitjes së farërave nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, doganat dhe tatimet për të parandaluar futjen e farërave të kanabisit në vend;
2. Të realizohet bashkëpunimi i hershëm i shërbimeve inteligjente dhe policore me strukturat homologe të vendeve të origjinës së farërave;
3. Të intensifikohen kontrollet në serra dhe mjedise të tjera të mbyllura ku mund të kultivohen fidanët;
4. Të identifikohen personat që zotërojnë fuqi ekonomike për të mbjellë kanabis;
5. Të angazhohen maksimalisht organet e vetëqeverisjes vendore në fazën parandaluese;
6. Të shkëmbehet informacion midis Drejtorisë së Doganave me Policinë e Shtetit në lidhje me produktet e gjetura gjatë kontrolleve të kryera nga ana e strukturave të tyre, si: plehra kimike, dezinfektantë të ndryshëm, modelet e llambave të ndriçimit (ngrohëse) etj., si dhe të gjitha pajisjet ndihmëse të evidentuara gjatë operacioneve antikanabis, të cilat janë përdorur nga ana e kultivuesve të kësaj kulture.

**Rezultate të pritshme**

- Parandalimi i mbjelljes së fidanëve në mjedise të mbyllura;
- Zbulimi dhe shkatërrimi i sipërfaqeve të mbjella me fidanë;
- Identifikimi dhe procedimi i personave dhe rrjeteve të përfshira në kultivim dhe trafikim.

**Institucioni përgjegjës**

- PSH-ja.

**Institucione të tjera**

- Të gjitha institucionet e përfaqësuara në TFQ;
- Organet e vetëqeverisjes vendore;
- Partnerët ndërkombëtarë.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i fidanëve të shkatërruar;
- Numri i zonave të identifikuara;
- Numri i personave të përfshirë/proceduar.

Masa A.6: Përmirësimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes ajrore

**Qëllimi**

Përmirësimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes ajrore me qëllim monitorimin e territorit shqiptar dhe zbulimin e sipërfaqeve të mbjella me kanabis, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët/agjencitë ndërkombëtare.

**Përshkrim i shkurtër**

Kontrolli efektiv i territorit është një ndër parakushtet për goditjen e suksesshme të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit. Kapacitetet aktuale të vendit për kontrollin ajror janë të kufizuara. Zgjerimi i tyre nëpërmjet sigurimit të radarëve të vëzhgimit ajror, shtimit të aftësive të vëzhgimit ajror të flotës së helikopterëve të FA-së dhe PSH-së, futja në përdorim e mjeteve ajrore të papilotuara, si dhe kontraktimi i shërbimeve satelitore të vëzhgimit ajror janë në funksion të përmirësimit të kontrollit të territorit.

Për përmirësimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes ajrore të merren këto masa:

1. Të vijojë monitorimi ajror nga *Guardia di Finanzia* në zbatim të marrëveshjes së përbashkët me qeverinë italiane;
2. Të kontraktohen shërbimet satelitore të vëzhgimit, për sigurimin e imazheve në kohë reale të sipërfaqeve të mbjella me kanabis;
3. Të shtohen kapacitetet e mbikëqyrjes ajrore nëpërmjet:
   - Vendosjes së pajisjeve të vëzhgimit ajror në helikopterët ekzistues;
   - Sigurimit të radarëve të kontrollit dhe monitorimit të hapësirës ajrore;
   - Pajisjes me dronë;
4. Bashkëpunimi me ekspertët e policisë italiane për zbatimin e projektit SANCAS 2017–2019, për mbikëqyrjen ajrore/monitorimin nga ajri të territorit.

**Rezultate të pritshme**
- Monitorimi i territorit nëpërmjet patrullimit dhe mbikëqyrjes ajrore;
- Sigurimi i pamjeve vizuale nëpërmjet mjeteve vëzhguese satelitore/drone.
**Institucioni përgjegjës**
- MM-ja (Forcat Ajrore).

**Institucione të tjera**
- PSH-ja;
- Struktura partnere ndërkombëtare.
**Indikatorë të matshëm**
- Numri i orëve të fluturimit (të brendshme dhe ndërkombëtare);
- Numri i pamjeve satelitore;
- Numri i raporteve të mbikëqyrjes ajrore.

Masa A.7: Parandalimi, identifikimi, zbulimi, dokumentimi, goditja dhe shkatërrimi i grupeve kriminale të trafikimit

**Qëllimi**

Shënjimi dhe shkatërrimi i grupeve kriminale të organizuara, të përfshira në trafikimin e kanabisit (financuesit, organizatorët, trafikantët e drogës, ndërlidhësit, kultivuesit, shpërndarësit).

**Përshkrim i shkurtër:**

Trafikantët konsiderohen si kategoria e dytë më e rrezikshme e grupeve të organizuar kriminale, pas financuesve. Strukturat hetimore kanë përgjegjësi për goditjen efikase të grupeve kriminale që organizojnë dhe kryejnë trafikimin e lëndëve narkotike. Hetimet e përbashkëta kombëtare e ndërkombëtare dhe përdorimi i shtuar i metodave speciale të hetimit konsiderohen si mjete të rëndësishme në këtë proces.

Për goditjen dhe shkatërrimin e rrjeteve të trafikimit të merren këto masa:

1. Të bëhet trajnim i posaçëm i personelit të Policisë Kriminale;
2. Të shtohen kapacitetet logjistike të dedikuara;
3. Të zgjerohet rrjeti i informatorëve të Policisë Kriminale;
4. Të frenohen lëvizjet e shpeshta të personelit të aktivizuar në PKKK;
5. Të organizohen operacione të përbashkëta kombëtare e ndërkombëtare;
6. Të merret dhe shkëmbehet sa më shpejt dhe në mënyrë efikase informacioni dhe të vihet në eficiencë sistemi ERICP;
7. Të intensifikohet kontrolli i territorit, përmes angazhimit të të gjitha strukturave kompetente: PSH, FA, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), strukturat e vetëqeverisjes vendore, strukturat e bujqësisë, pyjeve, mjedisit, tatimeve dhe doganave;
8. Të përmirësohet baza e të dhënave, nëpërmjet përditësimit cilësor të informacionit;
9. Të fuqizohen kapacitetet analizuese, në funksion të njohjes së situatës kriminale;
10. Të shtohen hetimet proaktive dhe përdorimi i metodave speciale të hetimit, për sigurimin e provave ligjore dhe goditjen efektive të grupeve kriminale;
11. Të sekuestrohen e konfiskohen asetet kriminale.

**Rezultatet e pritshme**
- Identifikimi dhe goditja e grupeve të krimit të organizuar;
- Shtimi i numrit të referimeve në prokurori;
- Shtimi i numrit të aseteve kriminale të identifikuara, sekuestruara apo konfiskuara;
- PSH-ja.

**Institucione të tjera**
- MFE-ja;
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
- SHISH-i;
- Shërbimet për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA);
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Partnerë të tjerë relevantë;
- Organet e vetëqeverisjes vendore.

**Indikatorë të matshëm**
- Numri i grupeve kriminale të identifikuara, proceduara penalisht;
- Numri i çështjeve të hetuara nga Prokuroria dhe të dërguara për gjykim;
- Numri i çështjeve të përfunduara nga gjykata dhe i personave të dënuar;
- Vlera e aseteve të konfiskuara/sekuestruara me prejardhje kriminale.

Masa A.8: Krijimi i një mekanizmi eficient për grumbullimin, përpunimin, analizimin dhe raportimin në çdo kohë të të dhënave (zgjerimi i sistemit elektronik "*Gis-Narkotik*" dhe integrimi i sistemit MPÇ me sistemin e Prokurorisë dhe të Gjykatës).

**Qëllimi**

Njohja dhe raportimi në kohë i situatës lidhur me kultivimin e kanabisit.

**Përshkrim i shkurtër**

Në vijim të përpjekjeve të bëra, për të mundësuar formulimin e shpejtë dhe cilësor të raporteve, që lidhen me kultivimin e kanabisit, parashikohet krijimi i një mekanizmi të posaçëm për mbledhjen, administrimin, vlerësimin dhe përdorimin e informacionit.

Për krijimin e këtij mekanizmi të merren masat e mëposhtme:

1. Të krijohet një bazë të dhënash e dedikuar për kultivimin e bimëve kanabis, në bashkëpunim me: *The European Police Office (EUROPOL), European Monitoring Centre for drugs and drug addicition (EMCDDA).* Implementimi dhe përdorimi i instrumentit: *European Reporting Instrument for sites related to Cannabis Production (ERICP)* është element mbështetës për zbatimin e kësaj mase;
2. Të përditësohet baza e të dhënave me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendëse dhe të huaja, si dhe të raportohen në kohë problematikat që lidhen me kanabisin;
3. Të hartohen raporte periodike në vijimësi për vlerësimin dhe njohjen sa më të plotë të gjendjes nga të gjitha institucionet e përfaqësuara në TFQ;
4. Të mbahen statistika të rregullta për problematikat e PKKK-së;
5. Të analizohen të dhënat periodike të raportuara nga prokuroritë e rretheve për rastet e procedimeve të regjistruara për kultivim/prodhim/trafikim të kanabisit.

**Rezultate të pritshme**

- Një bazë e avancuar të dhënash për kultivimin e kanabisit;
- Implementimi i sistemit ERICP;
- Raporte periodike për gjendjen;
- Përditësimi i të dhënave;
- Të dhëna statistikore për gjendjen.

**Institucioni përgjegjës**

- Ministria e Brendshme (MB).

**Institucione të tjera**

- Institucionet e përfaqësuara në TFQ;
- EUROPOL-i;
- EMCDDA-ja.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i informacioneve të vlefshme të administruara;
- Numri i raporteve të hartuara;
- Numri i analizave/studimeve të kryera;
- Numri i raporteve të shkëmbyera me partnerët.

Objektivi strategjik B: Reduktimi dhe shkurajimi i përdorimit të kanabisit dhe drogave në përgjithësi

Masa B.1: Përmirësimi i kapaciteteve të specializuara shëndetësore.

**Qëllimi**

Rritja e kapaciteteve të specializuara shëndetësore, me qëllim që t'u përgjigjen sa më mirë nevojave të pacientëve që trajtohen për problemet e varësisë nga droga.

**Përshkrim i shkurtër**

Krijimi i kapaciteteve spitalore dhe mjekësore për trajtimin e përdoruesve të drogës është një aspekt i rëndësishëm i PKKK-së. Përveç qendrës polivalente të trajtimit të personave me varësi nga droga, e cila ndodhet në Spitalin Universitar, nevojitet shtimi i kapaciteteve të reja edhe me qendra të tjera në Tiranë dhe në disa qarqe të vendit. Këto qendra, do t'i përgjigjen, jo vetëm numrit në rritje të atyre që kërkojnë trajtim, por edhe do të jenë më afër fizikisht komuniteteve në nevojë.

Kjo masë do të realizohet nëpërmjet:

1. Përforcimit dhe rritjes së kapaciteteve të qendrës polivalente të trajtimit të përdoruesve të narkotikëve;
2. Krijimit të shërbimeve rajonale në shërbim të komunitetit për përdoruesit e narkotikëve;
3. Vendosjes së shërbimeve specifike të trajtimit të drogave për grupet më të riskuara;
4. Krijimit të shërbimeve për të ndërvarurit në sistemin penitenciar;
5. Trajnimit të trajnuesve (mësues, mjekë dhe punonjës të kujdesit shëndetësor parësor, punonjësve socialë, punonjësve të policisë etj.) që punojnë në fushën e parandalimit;

6. Krijimit të kurrikulave të unifikuara për trajnim.

**Rezultate të pritshme**

- Shtimi i numrit të qendrave të trajtimit special të përdoruesve të drogës;
- Shtimi i numrit të pacientëve të trajtuar;
- Shtimi i specialistëve që trajtojnë pacientët e ndërvarur nga droga;
- Kompletimi i sistemit penitenciar me shërbimin për të ndërvarurit;
- Shtimi i personave të riintegruar.

**Institucioni përgjegjës**

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

**Institucione të tjera**

- MASR-ja;
- MB-ja;
- MD-ja;
- OJF-të.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i qendrave të reja të specializuara;
- Numri i pacientëve të ndërvarur që kanë nevojë për trajtim;
- Numri i pacientëve që janë trajtuar;
- Numri i personelit të trajnuar sipas specialiteteve.

Masa B.2: Përmirësimi i informacionit rreth kanabisit dhe drogave në përgjithësi, duke përditësuar kurrikulat e arsimit parauniversitar

**Qëllimi**

Përditësimi i njohurive të mësimdhënies/nxënies për çështjen e kanabisit nëpërmjet zgjerimit dhe kompletimit të kurrikulave.

**Përshkrim i shkurtër**

Si mjet për parandalim, MASR-ja, përveç përditësimit të kurrikulës, përgatitjes së moduleve apo përmirësimit të teksteve, vëmendje të veçantë do t'u kushtojë edhe aktiviteteve ekstrakurrikulare, nëpërmjet shtrirjes së tyre në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar.

Kjo masë realizohet nëpërmjet:

1. Zgjerimit dhe përditësimit të informacionit në kurrikulat e viteve të ndryshme shkollore;
2. Ofrimit të njohurive të nevojshme për nxënësit në lidhje me rreziqet e përdorimit të kanabisit;
3. Integrimit të njohurive, shprehive dhe qasjeve kurrikulare bashkëkohore, nga shtete me përvoja në këtë fushë;
4. Bashkërendimit të punës për parandalimin e fenomenit, duke krijuar një mjedis të shëndetshëm në shkollë dhe jashtë saj, me mbështetjen e vazhdueshme të punonjësve të policisë;
5. Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve nëpërmjet përdorimit më efektiv të këshillit të shkollës;
6. Rritjes së rolit të qeverisë së nxënësve, për organizimin e aktiviteteve për të trajtuar çështjen;
7. Reflektimit të konkluzioneve të raporteve të nxjerra nga strukturat e specializuara: Instituti i Zhvillimit Arsimor (IZHA) dhe Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) në kurrikula.

**Rezultate të pritshme**

- Njohuri, shprehi dhe qasje kurrikulare bashkëkohore, të përafruara me praktikat e shteteve me përvojë në këtë fushë;
- Prania e rregullt e punonjësve të policisë në shkolla;
- Hartimi i moduleve kurrikulare;
- Hartimi i module të trajnimit;
- Shpërndarja e posterave dhe fletëpalosjeve dhe e materialeve të tjera informuese.

**Institucioni përgjegjës**

- MASR-ja.

**Institucione të tjera**

- IZHA-ja;
- ISHP-ja;
- Drejtoritë arsimore rajonale (DAR)/zyrat arsimore;
- PSH-ja;
- Organet e vetëqeverisjes vendore;
- MSHMS-ja;
- Partnerët.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i orëve që i dedikohen edukimit kundër drogave;
- Numri i shkollave/klasave të përfshira në programet edukative;
- Numri i mësuesve të trajnuar;
- Numri i moduleve të mësimdhënies/të trajnimit të përgatitura;
- Numri i manualeve të trajnimit;
- Numri i materialeve informuese, ndërgjegjësuese, përfshirë postera, fletëpalosje, video të shkurtra, veprimtari sportive, spote etj.

Masa B.3: Krijimi, sigurimi dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara nga interneti

**Qëllimi**

Mirorganizimi, menaxhimi dhe përdorimi i shërbimeve të ofruara nga interneti për përfshirjen më të gjerë të publikut në çështjen e luftës kundër kanabisit.

**Përshkrim i shkurtër**

Përdorimi i internetit si platformë informimi dhe komunikimi është instrument shumë i rëndësishëm pasi informacioni i shpërndarë nëpërmjet internetit përcillet në një rrugë më të shkurtër dhe është më i aksesueshëm nga grupet me risk të lartë për t'u përfshirë në fenomen.

Për sigurimin e zbatimit të kësaj mase të ndërmerren këto veprime:

1. Përdorimi i kombinuar i medieve moderne me ato tradicionale, si mjete për të përcjellë informacione të dobishme për informimin, por dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin publik;
2. Përdorimi i medies për marrjen e informacioneve nga qytetarët për goditjen e dukurisë;
3. Ndërtimi i faqeve të dedikuara, të cilat të ofrojnë informacion të dobishëm dhe programe edukimi për të rinjtë kundër lëndëve narkotike;
4. Rritja e ndërveprimit të policisë në rrjetet dhe mediet sociale, për të shtuar mundësitë e komunikimit me qytetarët dhe veçanërisht me të rinjtë;
5. Përmirësimi i materialeve dhe informacioneve të disponueshme *online*;
6. Kryerja e studimeve *online* dhe krijimi i mundësive për përfshirje në forume.

**Rezultate të pritshme**

- Krijimi, përmirësimi i shërbimeve të internetit;
- Përmirësimi i cilësisë së informacioneve, materialeve të ngarkuara *online;*
- Përdorimi i medieve sociale të destinuara veçanërisht për çështjen e narkotikëve;
- Kryerja e vëzhgimeve *online* dhe pjesëmarrje e gjerë në forume.

**Institucioni përgjegjës**

- MASR-ja.

**Institucione të tjera**

- MSHMS-ja;
- MB-ja;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Universitetet;
- Partnerët.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i shërbimeve të internetit të aksesueshme;
- Numri i përdoruesve të këtyre shërbimeve;
- Numri i materialeve të ngarkuara *online*.

Masa B.4: Reduktimi i kërkesës së brendshme.

**Qëllimi**

Reduktimi i kërkesës së tregut të brendshëm nëpërmjet uljes së numrit të përdoruesve.

**Përshkrim i shkurtër**

Ndonëse shumë herë më e vogël se kërkesa ndërkombëtare, edhe kërkesa e brendshme ka njohur rritje. Kërkesë e shtuar është konstatuar nga të rinjtë, kryesisht në klubet e natës, mjediset turistike, lokalet luksoze, por dhe në shkollat e mesme dhe universitete.

Ulja e kërkesës së brendshme është një tjetër objektiv i rëndësishëm, i cili arrihet nëpërmjet kombinimit të masave si më poshtë:

1. Kryerja e vlerësimeve periodike (2-vjeçare) ndërinstitucionale për nivelin e konsumimit të narkotikëve në shkolla dhe në mjedise të tjera;
2. Bashkërendimi i punës mes PSH-së dhe institucioneve të tjera në mbështetje të popullsisë së zonave të riskuara, nëpërmjet zhvillimit të projekteve të ndryshme kulturore dhe sportive;
3. Monitorimi i procesit të trajtimit të përdoruesve;
4. Përforcimi i kontrolleve në shkolla, konvikte, qendra sociale dhe mjedise publike me frekuentim të

lartë nga rinia;

5. Përfshirja e sistemit shkollor parauniversitar, në programet e informimit, sensibilizimit dhe edukimit parandalues ndaj përdorimit të lëndëve narkotike;

6. Trajtimi me psikologë i përdoruesve në të gjitha rastet;

7. Zhvillimi i programeve sociale për edukimin, punësimin, riintegrimin e përdoruesve;

8. Përfshirja e gjithë aktorëve të tjerë (familjes, shoqërisë, shkollës);

9. Zbatimi i plotë i politikave antiduhan si masë parandaluese.

**Rezultate të pritshme**

- Reduktimi i numrit të përdoruesve nëpërmjet programeve sociale;
- Sigurimi i trajtimit me psikologë të përdoruesve;
- Materiale mbështetëse mësimore në sistemin parauniversitar.

**Institucioni përgjegjës**

- MASR-ja.

**Institucione të tjera**

- Të gjitha institucionet e përfaqësuara në TFQ.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i përdoruesve të evidentuar nga të dhënat zyrtare;
- Numri i përdoruesve nga studime dhe vlerësime të besueshme;
- Numri i raporteve të përbashkëta ndërinstitucionale.

Masa B.5: Zbatimi i nenit 1, të ligjit, "Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.7.1995, "Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope"[7], si dhe të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**Qëllimi**

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet strukturave ligjzbatuese për zbatimin efektiv të nenit 10/1 të ligjit, "Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope".

**Përshkrim i shkurtër**

Kryetarët e njësive bazë të vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin ligjor për raportimin e rasteve të lidhura me drogën. Praktika ka treguar se organet ligjzbatuese nuk janë treguar përherë rigoroze në procedimin ligjor ndaj autoriteteve vendore, kur në territorin e administruar prej tyre janë evidentuar sipërfaqe të kultivuara me kanabis. PKKK-ja parashikon një qasje shumë rigoroze ndaj rasteve të mosraportimit të fenomenit të kultivimit të kanabisit brenda juridiksionit administrativ të autoriteteve vendore përgjegjëse.

Për zbatimin e kësaj mase të ndërmerren këto veprime:

1. Zhvillimi i seancave të organizuara të njohjes, ku të gjithë personat përgjegjës marrin dhe konfirmojnë njoftimin zyrtar për përgjegjësitë ligjore;

2. Administrimi i raporteve periodike nga të gjithë zyrtarët vendorë lidhur me gjendjen e territoreve në juridiksionin e tyre.

**Rezultate të pritshme**

- Kryerja e një kontrolli më të mirë të territorit nën juridiksionin e autoriteteve përgjegjëse vendore;
- Kryerja e raportimeve në kohë të rasteve të kultivimit të kanabisit në organet ligjzbatuese;
- Vënia para përgjegjësisë ligjore e funksionarëve që nuk zbatojnë këtë detyrim ligjor.

**Institucioni përgjegjës**

- PSH-ja;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjekte të ligjit nr. 7975/1995 dhe të ligjit nr. 139/2015;
- Prokuroria e Përgjithshme.

**Institucione të tjera**

- Të gjitha institucionet që përfaqësohen në TFQ.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i çështjeve të referuara nga policia dhe organet e tjera ligjzbatuese në Prokurori;
- Numri i të proceduarve.

Objektivi strategjik C: Përforcimi i bashkëpunimit, koordinimit dhe rritja e kapaciteteve

Masa C.1: Krijimi i Komitetit Ndërinstitucional (KN) dhe i Task-Forcës Qendrore (TFQ).

**Qëllimi**

Krijimi dhe vënia në funksion e strukturave koordinuese dhe drejtuese ndërinstitucionale në nivel qendror.

**Përshkrim i shkurtër**

Koordinimi i përpjekjeve të të gjitha institucioneve të përfshira në parandalimin dhe goditjen e kultivimit,

[7] Ligj nr. 9559/2006.

trafikimit dhe përdorimit të kanabisit konsiderohet si rruga më e drejtë për arritjen e suksesit.

KN-ja është struktura qeveritare e ngarkuar me hartimin e politikave, sigurimin e mbështetjes dhe vlerësimin e punës së institucioneve të angazhuara në zbatimin e PKKK-së. KN-ja drejtohet nga ministri i Brendshëm dhe ka në përbërje: ministrin e Mbrojtjes, ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrin e Drejtësisë, drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Informativ të Shtetit, ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrin e Financave dhe Ekonomisë, ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministrin e Turizmit dhe Mjedisit dhe këshilltarin e Kryeministrit për Sigurinë.

Në mbledhjet e Komitetit Ndërinstitucional ftohen të marrin pjesë Prokurori i Përgjithshëm, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera që kanë interes për zbatimin e Planit të Veprimit.

TFQ-ja, e përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme, Shërbimit Informativ të Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Forcave të Armatosura, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe nga institucione të tjera që koordinon, drejton, kontrollon dhe vlerëson të gjithë punën që bëhet për zbatimin në praktikë të PKKK-së.

TFQ-ja është në varësi dhe raporton pranë drejtuesit të Komitetit Ndërinstitucional.

Për krijimin e strukturave drejtuese dhe koordinuese në nivel qendror dhe vendor të merren edhe këto masa:

1. Krijimi i KN-së dhe TFQ-së me urdhër të posaçëm të Kryeministrit;
2. Krijimi i task-forcave vendore me urdhër të prefektit të qarkut;
3. Vënia në funksion e bazës qendrore të të dhënave përmes sistemit ERICP.

**Rezultate të pritshme**

- Aktivizimi i strukturave qendrore funksionale të koordinimit dhe kontrollit gjatë gjithë kohës së nevojshme për zbatimin e PKKK-së;
- Realizimi i koordinimit efektiv ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;
- Kryerja e vlerësime të përbashkëta të gjendjes përmes kontributeve të të gjitha institucioneve të përfshira;
- Organizimi i operacioneve të përbashkëta në zbatim të kërkesave të PKKK-së;
- Hartimi i raporteve periodike të përbashkëta për ecurinë e zbatimit të PKKK-së.

**Institucione përgjegjëse**

- KM-ja për KN-në dhe MB-ja për TFQ-në

**Institucione të tjera**

- MB-ja;
- PSH-ja;
- Prokuroria e Përgjithshme;
- SHISH-ja;
- MD-ja;
- MM-ja;
- FA-ja;
- MASR-ja;
- MSHMS-ja;
- MFE-ja;
- MBZHR-ja;
- MTM-ja;
- Pushteti vendor.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i takimeve të KN-së;
- Numri i takimeve të TFQ-së;
- Numri i vlerësimeve të TFQ-së;
- Numri i raporteve të TFQ-së;
- Numri i operacioneve të përbashkëta të organizuara nga TFQ-ja.

Masa C.2: Krijimi i grupeve *ad hoc* për hetimin e çështjeve të caktuara (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parasë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme).

**Qëllimi**

Hetimi i personave dhe i grupeve kriminale, të cilët përfshihen në financimin, kultivimin/prodhimin dhe

trafikimin e kanabisit. Hetimi pasuror i këtyre shtetasve dhe i subjekteve tregtare të regjistruara në pronësi të tyre dhe të personave të lidhur me ta. Identifikimi, parandalimi, zbulimi, dokumentimi, goditja dhe shkatërrimi i grupeve kriminale.

**Përshkrim i shkurtër**

Përditësimi dhe analizimi i të dhënave të organeve ligjzbatuese, përdorimi i informacionit të siguruar nga partnerët ndërkombëtarë, intensifikimi i hetimeve komplekse dhe të përbashkëta, duke përfshirë edhe aplikimin e metodave speciale të hetimit, mundëson zbulimin dhe goditjen e grupeve kriminale (financuesve, organizatorëve, trafikantëve, ndërlidhësve, kultivuesve dhe shpërndarësve).

Financuesit konsiderohen si kategoria më e rrezikshme në të gjithë aktivitetin kriminal të kultivimit, përdorimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe për këtë arsye identifikimi dhe goditja e tyre është prioritet parësor.

Për goditjen efikase të financave që mundësojnë kultivimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike të merren masat e mëposhtme:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), strukturat e inteligjencës, prokurorisë, policisë, hetimit tatimor dhe doganor të ndërtojnë grupe *ad hoc* të përbashkëta dhe në bashkëpunim me struktura partnere homologe ndërkombëtare të mbledhin dhe të analizojnë informacionin për të arritur hetimin kompleks dhe procedim penal të suksesshëm;

2. DPPP-ja dhe grupet e përbashkëta *ad hoc* të tatimeve dhe të doganave të intensifikojnë bashkëpunimin dhe inspektimet e bazuara në subjekte që kanë detyrim të evidentojnë transaksionet financiare, si: institucionet bankare, zyrat noteriale, shoqëritë e transfertave monetare, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat e këmbimit valutor, ekspertë kontabël dhe kontabilistë të miratuar, kompanitë e sigurimeve, subjekte të lojërave të fatit, shoqëritë e qiradhënies financiare (*Leasing*) etj.;

3. Të rishikohet legjislacioni penal për të diferencuar dënimet penale në përpjesëtim me sasitë e lëndës narkotike të kultivuar/konsumuar/trafikuar;

4. Shkëmbim i informacioneve i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me institucionet e tjera ligjzbatuese të ngarkuara me zbatimin e planit, me qëllim kryerjen e hetimeve pasurore të përbashkëta me strukturat e Policisë së Shtetit, hetimin tatimor, DPPPPP-së, si dhe sekuestrim i aseteve kriminale.

5. Analizë e *database*-ve të shkeljeve në DPD, me qëllim evidentimin e subjekteve që janë penalizuar, për shmangie të procedurave doganore në shuma të mëdha.

**Rezultate të pritshme**

- Lista e grupeve kriminale të identifikuara dhe të proceduara;
- Lista e grupeve kriminale të goditura/shkatërruara;
- Lista e personave të dënuar;
- Ndryshime të legjislacionit;
- Evidentimi i personave të përfshirë në veprimtari, të cilat lidhen me kultivimin dhe trafikimin e kanabisit, personave të lidhur me ta, si dhe subjekteve tregtare në të cilat mund të kenë investuar;
- Justifikimi i aseteve me të ardhura të ligjshme, nëse të ardhurat nuk justifikohen do të bëhet rivlerësim tatimor për përllogaritjen e tatimeve që shtetasit duhet të paguajnë në administratën tatimore.

**Institucioni përgjegjës**

- PSH-ja.

**Institucione të tjera**

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve);
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Shërbimet e Inteligjencës;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);
- Organet e vetëqeverisjes vendore.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i grupeve kriminale të identifikuara;
- Numri i grupeve kriminale të goditura/shkatërruara;
- Vlera e aseteve kriminale të zbuluara dhe të sekuestruara;
- Numri i çështjeve të referuara në Prokurori;
- Numri i personave të dënuar;
- Numri i personave dhe subjekteve të hetuar;
- Rivlerësimet për detyrimet tatimore të papaguara në administratën tatimore.

Masa C.3: Verifikimi i pastërtisë së figurës së funksionarëve publikë përgjegjës.

**Qëllimi**

Verifikimi i funksionarëve që rezultojnë se nuk kanë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrën, për goditjen e kultivimit dhe trafikimit, i atyre që i janë nënshtruar gjendjes së paligjshmërisë nëpërmjet përfshirjes në këtë aktivitet dhe ndarjes së fitimeve të siguruara nga kjo veprimtari e paligjshme.

**Përshkrim i shkurtër**

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit është i lidhur edhe me dobësitë dhe eficiencën e pamjaftueshme të personelit përgjegjës të angazhuar kundër këtij fenomeni. Një ndër shkaqet e ineficiencës është edhe korrupsioni, i cili është evidentuar në shumë raste. Në interes të goditjes së suksesshme të fenomenit, konsiderohet me shumë rëndësi goditja e vendosur e rasteve të korrupsionit në radhët e strukturave përgjegjëse. Verifikimi paraprak i përshtatshmërisë në detyrë për personelin e angazhuar kundër kanabisit është një hap i rëndësishëm në funksion të suksesit të këtij plani.

Për kryerjen e procesit të verifikimit të merren këto masa:

1. Të rishikohen kriteret dhe përforcohen kontrollet ndaj integritetit dhe personalitetit të zyrtarëve shtetërorë të ngarkuar me detyra në luftën kundër narkotikëve, në të gjitha nivelet;

2. Të verifikohet përshtatshmëria në detyrë e zyrtarëve të angazhuar në këtë fushë;

3. Të kryhen analizat e sukseseve dhe e problemeve të evidentuara gjatë ushtrimit të detyrës për zyrtarët e angazhuar;

4. Të kryhet verifikimi i pasurisë së zyrtarëve të cilët kanë rekorde problematike gjatë angazhimit kundër kanabisit. Për zyrtarët e parashikuar në germën "ë", të nenit 3, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, kontrolli do të kryhet nga ILDKPKI-ja bazuar në indicie/të dhëna, të dërguara zyrtarisht nga strukturat përkatëse të Ministrisë së Brendshme, të cilat vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratave të interesave private për këta zyrtarë;

5. Të kryhet verifikimi i lidhjeve eventuale me persona të inkriminuar;

6. Të kryhet verifikimi i kapaciteteve të tyre profesionale.

**Rezultate të pritshme**

- Evidentimi i lidhjeve të mundshme kriminale dhe pasurisë së paligjshme të aktorëve kryesorë në këtë proces;
- Identifikimi i nëpunësve që nuk kanë përmbushur detyrat ligjore të tyre, të përfshirë në veprimtari të paligjshme;
- Krijimi i një mekanizmi institucional për verifikimin fillestar dhe vazhdues të pastërtisë së figurës së nëpunësve të këtyre strukturave.

**Institucione përgjegjëse**

- PSH-ja dhe SHÇBA-ja.

**Institucione të tjera**

- Të gjitha institucionet e përfaqësuara në TFQ;
- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i personave të verifikuar;
- Numri i personave të përjashtuar;
- Numri i çështjeve.

Masa C.4: Forcimi i kapaciteteve njerëzore/financiare/operative/teknike.

**Qëllimi**

Rritja e burimeve njerëzore, financiare, teknike dhe operative të angazhuara kundër kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit, nëpërmjet përfshirjes së një numri të gjerë institucionesh.

**Përshkrim i shkurtër**

Ngarkesa e organeve të ngarkuara me ligj dhe me një kontribut thelbësor deri më tani, në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të drogës, si: PSH-ja dhe SHISH-i, në një numër të madh veprimtarish dhe kompleksiteti i përballjes me fenomenin e kanabisit, kërkojnë burime të shumta njerëzore, teknike dhe materiale, të cilat mund të sigurohen vetëm nëpërmjet angazhimit të të gjitha institucioneve që kanë mundësi dhe detyrë për të kontribuar. Përveç shtimit të burimeve njerëzore, me rëndësi të madhe është trajnimi i tyre i përshtatshëm për një përfshirje të suksesshme kundër kanabisit. Shtimi i burimeve njerëzore kundër kanabisit do të kontribuojë për forcimin e kontrollit të territorit, për ndërgjegjësimin më të mirë të qytetarëve, si dhe për shpërndarjen më të drejtë të ngarkesës operacionale mes organeve ligjzbatuese dhe institucioneve të tjera që kanë lidhje me çështjen.

Në interes të rritjes së kapaciteteve njerëzore, teknike, financiare, operacionale dhe informuese të merren këto masa:

1. Identifikimi dhe trajnimi i posaçëm i personelit që do të përfshihet në zbatimin e PKKK-së si në

nivelin qendror ashtu edhe vendor;

2. Përcaktimi i pikave të kontaktit në të gjitha strukturat qendrore dhe lokale të ngarkuara me zbatimin e PKKK-së;

3. Përcaktimi i kapaciteteve teknike dhe materiale që institucionet do të angazhojnë në zbatim të PKKK-së;

4. Përcaktimi i burimeve të mbështetjes financiare në të gjitha institucionet e përfshira.

**Rezultate të pritshme**

- Rritja e numrit të punonjësve;
- Shtimi i mjeteve dhe i pajisjeve;
- Sigurimi i mbështetjes financiare.

**Institucioni përgjegjës**

- MB-ja/PSH-ja.

**Institucione të tjera**

- MFE-ja;
- MM-ja;
- DPT-ja;
- DPD-ja;
- DPPPP-ja;
- Agjencia për Administrimin dhe Sekuestrimin e Aseteve të Konfiskuara;
- SHISH-i.

**Indikatorë të matshëm:**

- Numri i punonjësve të angazhuar;
- Numri i pajisjeve dhe i mjeteve të përdorura;
- Fondet e alokuara.

Masa C.5: Krijimi i task-forcave në nivel vendor.

**Qëllimi**

Krijimi i task-forcave pranë prefektit të qarkut.

**Përshkrim i shkurtër**

Për zbatimin e PKKK-së ngrihen task-forca vendore pranë prefektëve të qarqeve. Në përbërje të task-forcave vendore do të ketë përfaqësues të strukturave në nivel vendor nga të gjitha institucionet e përfaqësuara në TFQ, si dhe përfaqësues të prefektit të qarkut dhe bashkive.

**Rezultate të pritshme**

- Realizimi i koordinimit dhe i bashkëveprimit efektiv në nivelin vendor;
- Shkëmbimi i gjerë i informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira.

**Institucioni përgjegjës**

- Prefekti i qarkut;
- Bashkitë dhe institucionet e përfaqësuara në TFQ;
- Institucione të tjera qendrore në nivel vendor.

Masa C.6: Ndërtimi dhe zgjerimi i partneriteteve.

**Qëllimi**

Zgjerimi i bashkëpunimit me aktorë të tjerë në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar në interes të shkëmbimit të informacionit dhe goditjes së fenomenit të kanabisit.

**Përshkrim i shkurtër**

Zgjerimi i frontit të përbashkët konsiderohet si element shumë i rëndësishëm në rritjen e efektivitetit të përballjes me kultivimin, trafikimin dhe përdorimin e kanabisit. Krahas angazhimit të strukturave shtetërore, një burim shumë i rëndësishëm mbështetjeje është edhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë të shoqërisë brenda vendit, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Prej këtij bashkëpunimi, pritet të sigurohet informacion më i plotë, ndarje më e mirë e dijes dhe përvojës, si dhe bashkëpunim operacional konkret në çështje të caktuara.

Për realizimin e kësaj mase të kryhen veprimet e mëposhtme:

1. Zgjerimi i partneriteteve ekzistuese dhe krijimi i partneriteteve të reja përmes memorandumeve të mirëkuptimit, marrëveshjeve dhe protokolleve të bashkëpunimit me partnerët strategjikë dhe palët e tjera me interes të përbashkët;

2. Vendosja e procedurave të rregullta për shkëmbimin e informacionit me vendet partnere, kryesisht me vendet fqinje, në funksion të krijimit të tablove të qarta mbi nivelin e trafikimit të kanabisit mes vendit tonë dhe vendeve të tjera;

3. Krijimi i partneriteteve me organizata jofitimprurëse dhe joqeveritare në funksion të angazhimit të

koordinuar të tyre në arritjen e objektivave të PKKK-së.

**Rezultate të pritshme**

- Zgjerimi i hartës së bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarët;
- Përmirësimi i elementeve të bashkëpunimit me vendet e rajonit;
- Zgjerimi dhe përmirësimi i hartës së bashkëpunimit me aktorë të tjerë joqeveritarë dhe jofitimprurës.

**Institucioni përgjegjës**

- MB-ja.

**Institucione të tjera**

- SHISH-i;
- MFE-ja;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i instrumenteve të bashkëpunimit të nënshkruara;
- Numri i trajnimeve të zhvilluara;
- Numri i partnerëve ndërkombëtarë të rinj të bashkuar, bazuar në instrumentet e bashkëpunimit të nënshkruara.
- Objektivi strategjik D: Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe zhvillimi i projekteve

Masa D.1: Intensifikimi dhe rritja e numrit të fushatave mediatike.

**Qëllimi**

Hartimi dhe zbatimi i një plani të integruar të informimit dhe komunikimit, i cili synon shkëmbimin efektiv të informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në zbatimin e PKKK-së me publikun e gjerë.

**Përshkrim i shkurtër**

Informimi i përshtatshëm i publikut është një mjet i rëndësishëm në përpjekjen për goditjen e fenomenit të kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit. Nëpërmjet këtij procesi sigurohet ndërgjegjësimi i publikut dhe shkëmbimi i informacionit të rëndësishëm.

Krahas rolit të rëndësishëm që do të vijojnë të luajnë mediet tradicionale, një rol të rëndësishëm në këtë proces do të marrin mediet moderne dhe veçanërisht ato sociale.

Duke e konsideruar medien si një instrument mjaft të fuqishëm komunikimi me publikun të ndërmerren veprime konkrete si më poshtë:

1. Shfrytëzimi i vëmendjes së medieve, duke përmirësuar performancën e zyrave të komunikimit të ministrive përgjegjëse;
2. Shtimi i kontributeve të drejtpërdrejta kundër kanabisit në mediet tradicionale dhe *online* nga të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e PKKK-së;
3. Rritja e transparencës në lidhje me veprimet e aktorëve shtetërorë;
4. Përdorimi i imazhit të personazheve pozitive të artit, kulturës, sportit me ndikim të fuqishëm te të rinjtë;
5. Rritja e rolit të MSHMS-së dhe ISHP-së.

**Rezultate të pritshme**

- Ndërmarrja e fushatave mediatike në bashkëpunim me institucionet publike;
- Rritja e bashkëpunimit me mediet;
- Shpërndarja e njoftimeve në mediet kombëtare, publike dhe private, duke përfshirë edhe ato lokale.

**Institucioni përgjegjës**

- MB-ja.

**Institucione të tjera**

- Të gjitha institucionet që janë të përfaqësuar në Task-Forcën Qendrore.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i fushatave mediatike;
- Numri i audiencave;
- Numri i njoftimeve.

Masa D.2: Intensifikimi i takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve në luftën kundër kanabisit

**Qëllimi**

Rritja e dialogut dhe partneritetit me të gjithë aktorët për të adresuar bashkërisht problematikat e kultivimit të kanabisit, pasojat e konsumimit dhe trafikimit të drogës.

**Përshkrim i shkurtër**

Ndërgjegjësimi i publikut në luftën kundër kanabisit përbën një nga aspektet kryesore të PKKK-së. Me gjithë rëndësinë e komunikimit mediatik, komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun, me pjesëmarrjen

e të gjithë aktorëve të përfshirë në përpjekjen kundër kanabisit, mbetet një rrugë e pazëvendësueshme. Synimi kryesor në këtë drejtim mbetet organizimi i takimeve me të gjitha grup-moshat, veçanërisht me të rinjtë.

Kjo masë të realizohet nëpërmjet:

1. Bashkërendimit të punës së institucioneve qendrore dhe vendore për organizimin e takimeve me grup-moshat e ndryshme;
2. Ndjekjes së një kalendari të mirëfilltë takimesh të punonjësve të Policisë së Shtetit në shkolla dhe në komunitete të tjera me interes për fushën;
3. Organizimi i aktiviteteve të fushatave ndërgjegjësuese me asistencën e OSBE-së në Shqipëri, në disa qarqe;
4. Ndjekjes së një kalendari të plotë veprimtarish në shkolla kushtuar ndërgjegjësimit të nxënësve kundër kanabisit dhe drogave të tjera;
5. Përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertëve të tyre në mbështetje të veprimtarive publike;
6. Përfshirjes së medies në pasqyrimin e aktiviteteve kundër kanabisit;
7. Përfshirjes së figurave të artit, kulturës, sportit në përcjelljen e mesazheve kundër përdorimit të kanabisit.

**Rezultate të pritshme**

- Rritja e numrit të takimeve me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara;
- Rritja e numrit të seminareve/anketimeve të organizuara;
- Zgjerimi i rrjetit me të gjithë partnerët/aktorët në nivel rajonal dhe vendor për ndërmarrjen e përpjekjeve të përbashkëta për të rritur ndikimin e luftës kundër kanabisit dhe drogave;
- Rritja e numrit të aktorëve të përfshirë;
- Rritja e numrit të figurave të artit, kulturës, sportit.

**Institucioni përgjegjës**

- MASR-ja.

**Institucione të tjera**

- MB-ja;
- Ministria e Kulturës;
- MSHMS-ja;
- Organet e vetëqeverisjes vendore;
- OJF-të.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i seminareve/takimeve të organizuara;
- Numri i pjesëmarrësve në seminare/takime;
- Numri i personaliteteve të angazhuara.

Masa D.3: Shkurajimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në kultivimin e bimëve narkotike dhe nxitja e veprimtarive të ligjshme ekonomike.

**Qëllimi**

Parandalimi i përfshirjes së qytetarëve në kultivimin e kanabisit, nëpërmjet përdorimit të kombinuar të masave shtrënguese ligjore dhe programeve të zhvillimit ekonomik.

**Përshkrim i shkurtër**

Kategoria e "punëtorëve" është më e madhja në numër në aktivitetin kriminal të kultivimit. Kultivuesit e kanabisit paguhen kryesisht vetëm për punën e krahut, ndaj parandalimi i përfshirjes së tyre në këtë aktivitet kriminal është një mundësi reale. Punëtorët e krahut rekrutohen nga radhët e qytetarëve të zonave periferike apo rurale, kryesisht të papunë dhe me kushte ekonomike e sociale të vështira.

Për përmbushjen e qëllimit të merren masat e mëposhtme:

1. Të ndërgjegjësohen qytetarët për pasojat ligjore për përfshirjen në veprimtarinë kriminale të kultivimit të kanabisit;
2. Të nxitet vetëpunësimi, përmes lehtësimit të skemave të financimit dhe krijimit të alternativave të ligjshme të punësimit për qytetarët me risk;
3. Të realizohet shtrirja e programeve të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, në zonat e riskuara, duke synuar mbështetje ekonomike për familjet, që nuk mund të angazhohen në programet e vetëpunësimit;
4. Të realizohet shtrirja e programeve të strehimit edhe në zona rurale, duke synuar mbështetjen e familjeve në pamundësi absolute për të zgjidhur vetë çështjen e strehimit;
5. Të mbulohen shpenzimet për shkollim dhe strehim të fëmijëve të familjeve në nevojë, të zonave të thella malore dhe rurale duke synuar shkollimin e përshtatshëm të tyre në qendra urbane;

6. Të ofrohen tekste shkollore falas për fëmijët e familjeve në nevojë, në zonat e identifikuara si problematike, duke iu mundësuar këtyre fëmijëve frekuentimin e shkollës;

7. Të adaptohen programe të trajnimit profesional për banorët e zonave me risk, me qëllim rritjen e mundësive të punësimit dhe vetëpunësimit për të rinjtë dhe gratë;

8. Të riorientohen programet e mbështetjes bujqësore, blegtorale drejt fermerëve të riskuar duke synuar mbështetjen e tyre financiare. Në kuadër të këtyre programeve të posaçme, çdo vit të vihen në dispozicion të kësaj kategorie rreth 10% e buxhetit të parashikuar për mbështetjen e prodhimit bujqësor, blegtoral;

9. Të zhvillohen programe për të motivuar, nxitur dhe mbështetur kultivimin e bimëve mjekësore, prej të cilave sigurohen po aq përfitime sa nga kultivimi;

10. Nxitja e mbjelljes me fokus në kultura permanente;

11. Përmirësimi i sistemit të ujitjes me pika;

12. Përmirësimi teknologjik (ujitje me pika, ngrohje me biomasë për serra, plastmasë termike, polenizim serrash me bletë);

13. Rritja e sipërfaqes së tokës së punuar dhe kultivuar me drithëra;

14. Diversifikimi i të ardhurave të fermerëve;

15. Zhvillimi i agroturizimit në fshatra (bujtina/hoteleri, punishte prodhim artizanal, stanet);

16. Të nxiten dhe mbështeten studime shkencore për të gjetur rrugë të reja të zhvillimit bujqësor (zëvendësimi i produkteve) duke inkuadruar, angazhuar universitetet, *United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC)*;

17. Zhvillimi alternativ nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese dhe trajnimeve nga UNODC-ja;

18. Të zhvillohen projekte/programe të reja për blegtorinë;

19. Të përfshihen me prioritet, në programet e posaçme të nxitjes së punësimit, grupet e riskuara për përfshirjen në veprimtarinë kriminale të kultivimit të kanabisit, siç janë personat me aftësi të kufizuar, jetimët, gratë kryefamiljare, të rinjtë, pjesëtarë të komuniteteve të margjinalizuara etj.;

20. Të krijohet një fond i posaçëm në buxhetin e shtetit, i cili alokon mjetet e nevojshme financiare nëpërmjet përdorimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe kontributeve të partnerëve ndërkombëtarë e donatorëve.

**Rezultate të pritshme**

- Reduktimi progresiv vjetor i sipërfaqeve të pakultivuara dhe mbjellja e tyre me bimë bujqësore;
- Rritja e niveleve të punësimit në zonat rurale;
- Zgjerimi i sipërfaqeve bujqësore të kultivuara me kultura alternative;
- Zhvillimi i programeve socio-ekonomike.

**Institucione përgjegjëse**

- MBZHR-ja dhe organet e vetëqeverisjes vendore.

**Institucione të tjera**

- MFE-ja (Shërbimi Kombëtar i Punësimit);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR);
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Organet e vetëqeverisjes vendore;
- Universitetet;
- UNODC-i;
- BE-ja.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i programeve të zhvilluara, ekzistuese dhe të zbatuara;
- Numri i individëve që kanë përfituar nga programet sociale;
- Numri i individëve që kanë përfituar nga programet e posaçme të nxitjes së punësimit;
- Buxheti dhe burimet e akorduara;
- Sipërfaqet e mbjella me produkte bujqësore të ligjshme;
- Numri i personave të punësuar/vetëpunësuar në zonat rurale të riskuara;
- Numri i studimeve bujqësore, shkencore, të realizuara në zonat e riskuara.

Masa D.4: Inkurajimi i publikut dhe krijimi i mundësive për mbledhjen e informacionit nga sinjalizuesit.

**Qëllimi**

Sigurimi i informacioneve me vlerë mbi veprimtarinë e individëve dhe/ose grupeve kriminale, të përfshirë në kultivimin e kanabisit dhe trafikimin e lëndëve narkotike, nëpërmjet krijimit të mundësive për

aktivizimin e sinjalizuesve.

**Përshkrim i shkurtër**

Legjislacioni i miratuar në vitin 2016 për informuesit (sinjalizuesit)[8] dhe masat e marra kundër korrupsionit krijojnë një bazë të mirë për të identifikuar rastet e korrupsionit nga zyrtarët që favorizojnë kultivimin apo trafikimin e lëndëve narkotike.

PKKK-ja parashikon që të krijojë mundësi praktike për mbledhjen e informacioneve nga sinjalizuesit qytetarë në funksion të goditjes së fenomenit të kanabisit.

Në zbatim të kësaj mase të ndërmerren veprimet e mëposhtme:

1. Të krijohen kushte praktike për mbledhjen e informacioneve nga sinjalizuesit, si dhe për ndjekjen e tyre në funksion të goditjes së veprimtarisë së korrupsionit dhe veprimtarive të tjera të paligjshme në fushën e kanabisit;
2. Të krijohet një mekanizëm vlerësimi dhe shpërblimi për punën e sinjalizuesve;
3. Të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional për menaxhimin dhe administrimin e informacioneve të siguruara.

**Rezultate të pritshme**

- Ngritja e një mekanizmi funksional që mbledh, përpunon dhe analizon informacione nga sinjalizuesit;
- Zhvillimi i procedurës efektive për shpërblimin e informacioneve të vlefshme;
- Ngritja e fondeve efektive për shpërblimin e dhënies së informacioneve.

**Institucioni përgjegjës**

- TFQ-ja.

**Institucione të tjera**

- MFE-ja (Shërbimi Kombëtar i Punësimit);
- MD-ja;
- Bashkitë;
- MB-ja/SHÇBA-ja.

**Indikatorë të matshëm**

- Numri i raporteve të marra nga informuesit;
- Sasia e fondeve të përdorura për shpërblime;
- Numri i rasteve të raportuara nga informuesit, të ndjekura penalisht.

Masa D.5: Zgjerimi i përdorimit të aplikacionit "Komisariati Dixhital".

**Qëllimi**

Përfshirja e rubrikës "Droga" në aplikacionin "Komisariati Dixhital", me qëllim denoncimin e rasteve të lidhura me kanabisin dhe drogat e tjera.

**Përshkrim i shkurtër**

Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2016, ka filluar zbatimin e aplikacionit "Komisariati Dixhital". Kjo platformë e suksesshme ka kontribuar në marrjen në kohë reale të informacionit nga qytetarët, në lidhje me veprimtaritë kriminale. Zgjerimi i këtij aplikacioni edhe me një rubrikë të dedikuar rasteve të kultivimit, trafikimit apo përdorimit të narkotikëve i shërben informimit të autoriteteve përgjegjëse.

Për përmirësimin e mëtejshëm të këtij aplikacioni të ndërmerren këto veprime:

1. Të shtohet një rubrikë në aplikacion për rastet e denoncimit të veprave penale që lidhen me drogat;
2. Të përdoren mediet sociale në funksion të promovimit të aplikacionit në mbështetje të aktiviteteve të Policisë së Shtetit;
3. Të inkurajohen qytetarët të përdorin platformat digjitale dhe aplikacionet për të denoncuar rastet e lidhura me drogën që konstatojnë.

**Rezultate të pritshme**

Rritja e raportimeve në aplikacionin "Komisariati Dixhital";

Adresimi dhe zgjidhja e rasteve të raportuara në "Komisariatin Dixhital".

**Institucioni përgjegjës**

- MB-ja.

**Institucione të tjera**

- Institucione të tjera qendrore në nivel vendor;
- MSHMS-ja.

**Indikatorë të matshëm**

---

[8] Ligji nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

- Numri i shtuar i rubrikave;
- Numri i shtuar i përdoruesve të rubrikës së re.

KAPITULLI IV
MONITORIMI DHE VLERËSIMI

**1. Monitorimi periodik**

**Krahas masave për zbatimin e PKKK-së, monitorimi i vazhdueshëm dhe kontrolli rigoroz për efektivitetin e angazhimit të strukturave konsiderohen si masa të përhershme dhe të vazhdueshme që mundësojnë vlerësimin real të gjendjes dhe përgjigjen e përshtatshme ndaj saj.**

Thelbin e vlerësimit të punës së institucioneve dhe të autoriteteve të përfshira në goditjen ndaj kultivimit, trafikimit dhe përdorimit të kanabisit e përbën suksesi në identifikimin, goditjen, shkatërrimin dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të grupeve dhe rrjeteve kriminale me aktivitet në fushën e kanabisit.

Grupin e indikatorëve kryesorë dhe më domethënës e përbëjnë ata që kanë të bëjnë me numrin e grupeve dhe rrjeteve kriminale të identifikuara, goditura dhe shkatërruara. Indikatorët më të rëndësishëm në këtë grup, janë:
- Numri i grupeve kriminale të identifikuara;
- Numri i grupeve kriminale të goditura/shkatërruara;
- Numri i operacioneve policore të suksesshme;
- Numri i operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare.

Një grup tjetër i rëndësishëm indikatorësh matin eficiencën e procedimit penal për financuesit dhe drejtuesit e rrjeteve dhe të grupeve kriminale të proceduara dhe të vendosura përpara drejtësisë, ku më të rëndësishmit, janë:
- Numri i drejtuesve të grupeve kriminale të zbuluar dhe të nxjerrë përpara drejtësisë;
- Numri i financuesve të zbuluar dhe të nxjerrë përpara drejtësisë.

Goditja e aseteve që burojnë nga veprimtari kriminale matet nga një sërë indikatorësh të tjerë, ku më të rëndësishmit, janë:
- Numri i çështjeve të referuara në polici e prokurori;
- Numri i individëve për të cilët janë kryer verifikime në kuadër të procedimeve penale dhe investigimeve policore;
- Numri i takimeve të njësive të përbashkëta;
- Numri i inspektimeve të kryera;
- Numri i aseteve kriminale të zbuluara dhe të sekuestruara/konfiskuara;
- Vlera e aseteve kriminale të zbuluara dhe të sekuestruara/konfiskuara.

Suksesi i veprimtarisë parandaluese matet me një grup tjetër indikatorësh, matja e të cilëve kryhet në fazën fillestare të ciklit të kultivimit. Indikatorët më të rëndësishëm në këtë grup, janë:
- Sasia e farës së konfiskuar;
- Serra dhe mjedise të tjera të identifikuara ku kultivohen fidanë;
- Numri i fidanëve të zbuluar dhe konfiskuar;

Një seri tjetër indikatorësh matin shkallën e angazhimit të institucioneve për të zbutur pasojat që vijnë nga goditjet e organeve ligjzbatuese, kryesisht në fushën e riorientimit të fermerëve drejt veprimtarive alternative e të ligjshme, mbështetjes dhe lehtësimit të tyre, ndërgjegjësimit të publikut, parandalimit të dëmeve të kanabisit etj. Indikatorët më të rëndësishëm në këtë seri, janë:
- Numri i individëve dhe familjeve që kanë përfituar nga programet sociale;
- Sipërfaqet e mbjella me kultura bujqësore të ligjshme;
- Numri i personave të punësuar/vetëpunësuar në zonat rurale të riskuara;
- Sasia e fondeve të vëna në dispozicion të programeve të mbështetjes.

**2. Raportimi**

Të gjitha institucionet dhe strukturat e përfshira në zbatimin e PKKK-së hartojnë raporte periodike mujore në zbatim të detyrimeve specifike të përcaktuara në këtë plan.

Strukturat e përbashkëta (task-forcat në nivel qendror dhe vendor) hartojnë raporte të integruara mujore, si dhe vlerësime rreth zbatimit të të gjitha masave të parashikuara nga PKKK-ja.

**3. Rishikimi vjetor i Planit**

Zbatimi i elementeve të PKKK-së monitorohet dhe vlerësohet nga të gjitha institucionet dhe agjencitë e ngarkuara me zbatimin e tyre, sipas përgjegjësive konkrete të parashikuara.

Monitorimi dhe vlerësimi i integruar i zbatimit të PKKK-së kryhet nga Task-Forca Qendrore dhe Komiteti Ndërinstitucional.

Një vlerësim i përgjithshëm, rishikim dhe përditësim i PKK-së kryhet në bazë vjetore.

4. Buxheti

Çdo institucion i ngarkuar me zbatimin e këtij Plan Veprimi ka përllogaritur efektet financiare që do të sjellë implementimi i masave përkatëse. Ky efekt, është planifikuar të përballohet pjesërisht nga buxheti i institucionit përkatës, ndërsa pjesa e paplanifikuar do të përfshihet në PBA 2019–2020.

Efektet financiare për aktivitetet e masave janë paraqitur në mënyrë të detajuar në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

SHTOJCA 1
BAZA LIGJORE

**1. Ligjet e aplikueshme**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, të Kuvendit Popullor, ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007; nr. 9904; datë 21.4.2008 dhe nr. 88/2012 (datë 18.9.2012).
- Ligji "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, përditësuar në janar 2016.
- Ligji "Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope"[9];
- Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"[10];
- Ligji "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"[11];
- Ligj "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"[12];
- Ligji "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope"[13];
- Ligji "Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope"[14];
- Ligji "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimin nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"[15];
- Ligji "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"[16];
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 107/2016 "Për prefektin";
- Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (çështja e përgjegjësisë penale të përdoruesit vetjak dhe të kritereve të cilësimit të dozës së përdorur si "dozë e vogël") [17].

**2. Strategjitë në fuqi**

- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, trafiqeve të paligjshme dhe terrorizmit 2013–2020" dhe plani i veprimit operacional;
- Plan Veprimi i Policisë së Shtetit, "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike për vitin 2016;
- Strategjia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor 2014–2020;
- Strategjia e Konsolidimit të Tokës 2016–2030;
- Plani i Veprimit për Riintegrimin Social-Ekonomik të Grave dhe Vajzave Viktima të Trafikimit të Personave;
- Strategjia e Rendit Publik dhe Planit të Veprimit 2015–2020;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Plani i Veprimit 2015–2020;
- Strategjia kundër Korrupsionit 2015–2020;
- Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014–2020;
- Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2014–2020;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Vetëqeverisjen Vendore 2015–2020 (VKM-ja nr. 691,

---

[9] Ligj nr. 7975, datë 21.7.1995, amenduar nga ligjet: nr. 9271, datë 9.9.2004 dhe nr. 9559, datë 8.7.2006.
[10] Ligji nr. 9000, datë 30.1.2003.
[11] Ligji nr. 90/2012.
[12] Nr. 9936, datë 26.6.2008.
[13] Ligj nr. 8750, datë 26.3.2001, amenduar nga ligjet: nr. 14, datë 13.4.2001, ndryshuar në shtator 2016.
[14] Ligj nr. 8874, datë 29.3.2002, amenduar nga ligjet: nr. 12, datë 29.4.2002.
[15] Ligj nr. 10 192, datë 3.12.2009.
[16] Ligj nr. 60/2016.
[17] Vendim nr. 1, datë 27.3.2008.

datë 29.7.2015).

**3. Akte nënligjore në fuqi:**

- Urdhri i përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm dhe ministrit të Drejtësisë "Mbi funksionimin e shërbimeve juridike të policisë"[18];
- Urdhri i përbashkët ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Shëndetësisë "Mbi trajtimin e narkotikëve"[19];
- Memorandumi i vitit 2003, "Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar", ndërmjet ministrit të Brendshëm dhe drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror;[20]
- Urdhri i përbashkët i ministrit të Brendshëm, ministrit të Financave dhe ministrit të Bujqësisë "Mbi miratimin e rregullores "Mbi bashkëpunimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimit Doganor, Shërbimit Veterinar dhe Fitosanitar";
- Memorandumi i bashkëpunimit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjencisë për Administrimin e Mjeteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara[21];
- Urdhri i ministrit të Shëndetësisë që ofron rregulloren për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për licencimin e entiteteve që tregtojnë substanca narkotike ose psikotrope[22];
- Aktmarrëveshja "Mbi luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike" ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit të Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Koordinimit të Inspektimit të Ministrisë së Mjedisit[23];
- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Bujqësisë "Mbi kontrollin dhe monitorimin e entiteteve që mbjellin kërp industrial"[24];
- Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm, "Për bashkërendimin e raporteve mes prokurorive të rretheve gjyqësore dhe prokurorisë për krime të rënda"[25];
- Qarkorja e Prokurorit të Përgjithshëm, "Për rritjen e bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit, për ndjekjen penale të veprimtarisë së paligjshme të kultivimit të lëndëve narkotike"[26];
- Udhëzimi i përbashkët mes Prokurorit të Përgjithshëm[27], ministrit të Punëve të Brendshme[28] dhe ministrit të Shëndetësisë[29] dhe Ministria e Mjedisit" Për trajtimin e bimëve e lëndëve narkotike apo psikotrope".

Çdo vit janë miratuar aktet administrative e mëposhtme:

- Plani Kombëtar i Veprimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Plani i Veprimit Drejtorisë së Policisë së Shtetit;
- Plani Operacional për monitorimin nga ajri.

Konventa ndërkombëtare të ratifikuara:

- Konventa kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope" e vitit 1998;
- Konventa për Substancat Psikotrope të vitit 1971; si dhe
- Konventa e vetme kundër Drogave Narkotike, e ndryshuar nga protokolli i vitit 1972, për ndryshimin e Konventës së vetme mbi drogat narkotike, 1961.

## SHTOJCA 2
## INFORMACIONI MBI RASTET E REFERUARA NË PROKURORI PËR KULTIVIM DHE TRAFIKIM NARKOTIKËSH

*Tabela 1. Raste të referuara në prokurori nga policia për kultivimin e bimëve narkotike për periudhën 2010–2016*

---

[18] Nr. 1075/1, datë 15.4.2009 dhe nr. 1227/1, më 1.4.2009.

[19] Nr. 469/2, më 3.4.2008; nr. 1572/2, më 3.4.2008; nr. 1569, më 17.4.2008.

[20] Nr. 606, datë 17.3.2003.

[21] Nr. 5660, datë 29.9.2009.

[22] Nr. 390, datë 19.9.2007.

[23] Nr. 4586, datë 15.8.2008.

[24] Nr. 2538/1, datë ë 14.5.2007.

[25] Viti 2010.

[26] Viti 2016.

[27] Udhëzimi nr. 469/2, datë 3.4.2008.

[28] Udhëzimi nr. nr. 2487, datë 15.5.2017, "Për trajtimin e bimëve, lëndëve narkotike apo psikotrope dhe prekursorëve kimikë, të sekuestruara".

[29] Udhëzimi nr. 1569, datë 17.4.2008.

| Viti | Numri i rasteve | Zbuluar | Numri i bimëve | Autorë | Arrestuar, ndaluar | Gjendje të lirë | Në kërkim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2010** | 178 | 60 | 37216 | 79 | 52 | 13 | 14 |
| **2011** | 89 | 55 | 21267 | 79 | 47 | 19 | 13 |
| **2012** | 168 | 100 | 76185 | 113 | 94 | 9 | 10 |
| **2013** | 239 | 86 | 98491 | 96 | 60 | 16 | 20 |
| **2014** | 570 | 164 | 551414 | 204 | 105 | 37 | 62 |
| **2015** | 1198 | 382 | 797422 | 553 | 402 | 48 | 103 |
| **2016** | 1671 | 285 | 2536288 | 444 | 276 | 51 | 117 |

Grafikisht, paraqitet informacioni nga Prokuroria për Krimet e Rënda të Shkallës së Parë mbi numrin e procedimeve të regjistruara dhe numrin e të pandehurve, në periudhën 2002-2017, për dy grupe veprash penale: ***Grafiku 1***, përmban informacion për veprat penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve"; "Kultivim i bimëve narkotike"; "Organizim dhe drejtim i organizatave kriminale"; "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope"; "Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike", të parashikuara konkretisht nga nenet 283, 284, 284/a, 284/c dhe 285 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë; dhe ***Grafiku 2,*** përmban informacion mbi ndjekjen e veprës penale "Trafikim i narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

*Grafiku 1. Numri total i procedimeve të regjistruara dhe totali i të pandehurve për vepra të ndryshme penale lidhur me narkotikët*




*Grafiku 2. Numri i procedimeve të regjistruara dhe totali i të pandehurve për trafikim narkotikësh*




Krahas të dhënave të mësipërme, institucioni i Prokurorisë, më konkretisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Parë për Krime të Rënda, ka zhvilluar hetime për veprat penale që lidhen me narkotikët, në kuadër të grupeve të strukturuara kriminale dhe organizatave kriminale dhe kryerja e veprave penale në kuadër të grupit të strukturuar kriminal", parashikuar konkretisht në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

*Grafiku 3. Numri total i procedimeve penale të organizatave kriminale dhe grupeve të strukturuara kriminale për veprat penale që lidhen me narkotikët*




SHTOJCA 3
VLERËSIM I PUNËS SË INSTITUCIONEVE PËR VITIN 2017

Gjatë vitit 2017 është arritur që të ulet ndjeshëm kultivimi i kanabisit, falë kombinimit dhe ndërmarrjes në mënyrë të koordinuar të masave parandaluese dhe shtrënguese.

Në arritjen e këtyre rezultateve ka ndikuar edhe risia e këtij viti, në kuadër të masave të marra, që është krijimi dhe implementimi në rrjetin informatik të Policisë së Shtetit i sistemit elektronik **"GIS-NARKOTIK"**, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur hedhja, evidentimi, administrimi dhe analizimi i të dhënave dhe informacioneve për rastet e kultivimit të bimëve narkotike në shkallë vendi. Deri tani janë administruar në sistemin "MEMEX" **1427** informacione policore.

Ngritja dhe funksionimi i 12 task-forcave vendore nën drejtimin e prefektëve të qarqeve, ka ndikuar gjithashtu, në rezultatet pozitive në luftën ndaj këtij fenomeni.

Kështu, veprimtaria e task-forcave vendore, gjatë vitit 2017 është përqendruar kryesisht në:

- Angazhimin maksimal të organeve të vetëqeverisjes vendore në fazën parandaluese;
- Realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv në nivelin vendor;
- Shkëmbimin e gjerë të informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira;
- Goditjen dhe shkatërrimin e rrjeteve të kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, si dhe krijimin e mundësive për zhvillim të qëndrueshëm në komunitetet dhe zonat e prekura.

**Rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe fushatës sensibiluese, në këto drejtime:**

- Bashkëpunim me kryetarët e fshatrave ka qenë primare për sqarimin e fermerëve, për parandalimin e kultivimit të kanabisit dhe rrezikshmërinë që paraqet kultivimi i tij, dhe evidentimin e tokave të lira e të abandonuara që këto parcela të mos përdoren për kultivimin e kanabisit por të kultivohen me bimë bujqësore;
- Ndërgjegjësim i fermerëve për dëmet dhe pasojat që vijnë nga kultivimi dhe trafikimi i kanabisit;
- Orientim i fermerëve për punë të ndershme në kultivimet bujqësore e blegtorale, sipas rajonizimit dhe aktiviteteve bujqësore e blegtorale fitimprurëse;
- Promovim i skemave mbështetëse në bujqësi dhe blegtori për vitin 2017 dhe procedurat që ndiqen për aplikim, për përftimin nga këto skema.

Gjithashtu, në nivel vendor, vlen për t'u theksuar se, ka pasur një angazhim të drejtpërdrejtë të drejtorive të bujqësisë, inspektorateve të mjedisit dhe pyjeve në nivel vendor dhe të drejtorive/sektorëve të pyjeve e kullotave në bashki në evidentimin e sipërfaqeve të mundshme, të dyshuara, apo të mbjella me bimë narkotike, si dhe është bërë raportimi në mënyrë të vazhdueshme për gjendjen e sipërfaqeve që janë nën përgjegjësinë e tyre.

Viti 2017 është viti në të cilin janë identifikuar dhe asgjësuar **57.377** bimë narkotike të kultivuara, **5 herë më pak** se mesatarja e një viti gjatë periudhës 1995–2016. Gjithashtu, janë kapur 68 tonë, 234 kg, 368.33 g sasi marijuane në proces trafikimi, dhe identifikuar 1.460 autorë. Krahasuar me vitin 2016, sasia e marijuanës së konfiskuar është dyfish më e lartë (30 tonë 14 kg e 991.02 g), kurse numri i autorëve të identifikuar është 1.736.

***Korrupsioni në radhët e policisë***

Rëndësi e veçantë i është kushtuar kontrollit të integritetit të punonjësve të policisë gjatë përmbushjes së detyrave për identifikimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike. Integriteti i punonjësit të policisë, është baza mbi të cilën është ndërtuar puna, ku modeli i punonjësit të përkushtuar në zbatimin e detyrave është parësor.

Gjatë vitit 2017 janë hetuar disiplinarisht dhe verifikuar një numër i konsiderueshëm punonjësish policie, të cilët janë konstatuar në moszbatim të detyrave funksionale ose në shkelje të Rregullores së Policisë së Shtetit, si më poshtë:

- Kanë filluar 31 hetime proaktive, për kultivim dhe tregtim të lëndëve narkotike, ku përfshihen punonjës policie;
- Janë referuar në prokurori 11 raste për veprat penale "kultivim i bimëve narkotike", "trafikim të narkotikëve" dhe "prodhim dhe shitja e narkotikëve", ku përfshihen punonjës policie;
- Janë arrestuar/ndaluar 9 punonjës policie;
- Janë hetuar disiplinarisht dhe verifikuar 60 punonjës policie, nga të cilët 14 janë përjashtuar nga policia.

Gjithashtu, për vitin 2017 janë proceduar penalisht 110 shtetas-funksionarë (administratorë të njësive administrative, kryepleq fshati dhe inspektorë të shërbimit pyjor), për veprat penale "Shpërdorim detyre" dhe "Moskallëzim krimi", parashikuar nga nenet 248 dhe 300 i Kodit Penal, nga të cilët janë arrestuar 13 persona, ndaluar 1, ndjekur në gjendje të lirë 78 dhe shpallur në kërkim 3.

***Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe kontributi i institucioneve ligjzbatuese gjatë vitit 2017***

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, për vitin 2017, nga ana e SHISH-it janë dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Shtetit, 85 shkresa, 134 informacione, nga të cilat 34 informacione rezultojnë të saktë, me 4.471 bimë narkotike. Ndërsa nga SHÇBA-ja, për vitin 2017, në Drejtorinë e

Përgjithshme të Policisë Shtetit, janë dërguar 25 shkresa, 25 informacione, me 291 bimë narkotike.

Në bashkëpunim me *Guardia di Finanza* dhe projekti "SANCAS", janë kryer gjithsej 55 monitorime ajrore me 129 orë 15 min fluturimi nga të cilat 111.05 orë me sensorë dhe kamera, 18 orë 10 min pa sensorë dhe kanë ardhur 33 raporte monitorimi, ku ka rezultuar se, janë evidentuar në total 96 parcela, me 5.317 bimë narkotike, që përbëjnë 7.9 % të totalit të bimëve narkotike (66.925) të identifikuara dhe asgjësuara gjatë kësaj periudhe.

Nga procesi i skanimit i kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për periudhën janar–nëntor 2017 janë skanuar 20.7697 mjete. Më konkretisht, 55 raste në total, nga të cilat në 3 (tri) raste ka pasur cigare kanabisi dhe në 52 raste janë kapur në total 2.397.125 kg kanabis.

*Statistikisht procesi i skanimit sipas degëve doganore paraqitet si më poshtë:*

| Viti 2017 | Durrës | Kakavijë | Qafëthanë | Kapshticë | Morinë | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar–15 nëntor 2017 | 56521 | 25816 | 48057 | 42790 | 34513 | **207697** |

Të dhënat nga Prokuroria konfirmojnë që në 6-mujorin e parë, për vitin 2017, janë regjistruar 694 procedime për veprat penale "Prodhim dhe shitja e narkotikëve"; "Kultivim i bimëve narkotike"; "Organizim dhe drejtim i organizatave kriminale"; "Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope"; "Mbajtja, prodhimi dhe transportimi i substancave kimike", të parashikuara konkretisht nga nenet 283, 284, 284/a, 284/c dhe 285 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për këto vepra penale janë dërguar për gjykim nga Prokuroria, 477 të pandehur. Gjithashtu, janë regjistruar 121 procedime për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Për këtë vepër penale janë dërguar për gjykim nga Prokuroria, 44 të pandehur.

Institucion tjetër ligjzbatues, i cili për vitin 2017 ka pasur një rol të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Ky institucion ka përqendruar aktivitetin e tij në drejtim të rritjes së efikasitetit të sistemit parandalues përmes bashkëpunimit jo vetëm me subjektet raportuese të rasteve të dyshimta, institucione të tjera, agjencitë homologe, por edhe me organet ligjzbatuese te të cilat adresohet produkti final i punës së analizës së këtij institucioni. Statistikisht, ky institucion për periudhën janar–shtator 2017 ka kryer 115 referime në Prokurori.

Gjithashtu, nuk ka munguar asnjëherë bashkëpunimi në kohë reale nga ana e homologëve për çdo informacion të kërkuar nga Njësia e Inteligjencës Financiare shqiptare. Shkëmbimi i informacionit me strukturat homologe për periudhën janar–shtator 2017, nga ana statistikore, paraqitet si më poshtë:

| | **Shkresa** | | **Përgjigje** | |
|---|---|---|---|---|
| **Viti** | Të dërguara nga DPPPP-ja | Të marra nga homologët | Të dërguara nga DPPPP-ja | Të marra nga homologët |
| **Janar–shtator 2017** | 54 (10 prej të cilave informacion spontan) | 61 (14 prej të cilave informacion spontan) | 30 | 27 |

# ANEKSI I PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR KULTIVIMIT DHE TRAFIKIMIT TË KANABISIT

| | Objektivat e strategjikë | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa | | Qëllimi | Aktivitetet | Institucioni përgjegjës | Institucione të tjera përgjegjëse/ partnerët | Koha e fillimit të aktivitetit | Kohë-zgjatja | Moni-torimi periodik | Indikatorët | Buxheti |
| | **Objektivi A: Parandalimi dhe goditja e kultivimit dhe trafikimit të kanabisit** | | | | | | | | | |
| A.1 | **Identifikimi i objekteve/vendeve dhe sipërfaqeve me risk për kultivimin dhe trafikimin e Kanabisit, si dhe hartimi i hartave të sipërfaqeve potenciale që janë mbjellë në vite me kanabis.** | Identifikimi i sipërfaqeve të mbjella me kanabis dhe atyre potenciale për t'u mbjellë. | Krijimi i hartës sipas zonave me risk për kultivimin e kanabisit në tokat disponibël shtetërore me origjinë nga ish-NB, në bashkëpunim me ASIG-un. | **MBZHR** | PSH Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit, Integrimit të Zonave/Ndërti-meve Informale<br>MTM<br>Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme<br>Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në qarqe<br>Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë | | | | 1. Numri/shpeshtësia e përditësimeve.<br>2. Sipërfaqja e tokave të hartëzuara. | Buxheti i ASIG |
| | | | 1. Evidentimi i parcelave të tokës bujqësore për çdo fermer.<br>2. Evidentimi i parcelave të kullotave për çdo fshat.<br>3. Evidentimi i parcelave të inventarit të pyjeve të mundshme për mbjellje.<br>4. Evidentimi i fermave blegtorale.<br>5. Miratimi i programit të kontrollit për çdo sipërfaqe nga strukturat e bashkisë | | Organet e vetëqeverisjes vendore | Nëntor–dhjetor 2017 | Në vazhdimësi | Çdo 3 muaj | 1. Numri i parcelave të tokës bujqësore, sipas fshatrave e fermerëve (lista).<br>2. Lista e parcelave të kullotave e pyjeve sipas fshatrave.<br>3. Lista e fermave blegtorale.<br>4. Numri i kontrolleve nga sektor dhe numri i | Buxheti i bashkive përkatëse |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | (bujqësia, pyjet, urbanistika, kadastra, inspektorati vendor e policia bashkiake).<br>6. Bashkëpunimi me zyrat vendore të regjistrimit të pasurisë për dokumentacionin e tokës në pronësi për çdo fermer. | | | | | | kontrolleve të përbashkëta të strukturave të bashkisë për çdo muaj.<br>5. Lista e fermerëve që kanë marrë dokumentacionin e tokës në pronësi. | |
| A.2 | **Dhënia me qira e pronave publike për përdorim privat të ligjshëm.** | Reduktimi i mundësisë e shfrytëzimit të tyre për qëllime kriminale. | Krijimi i një strukture të veçantë në ministri për nxitjen e dhënies me qira të tokave bujqësore disponibël shtetëror me origjinë ish-NB. | **MBZHR** | MFE<br>DPD<br>PP<br>MM<br>SHISH<br>Partnerë ndërkombëtarë | Nga viti 2014 e në vazhdimësi | Deri në përfundim të procesit | | Sipërfaqe e tokës së dhënë me qira dhe numri i përfituesve. | Kostoja administrative |
| | | | 1. Miratimi nga Këshillat Bashkiakë të qirave të diferencuara për përdorimin e tokës dhe të kullotave nga fermerët në risk,<br>2. Mbështetje nga strukturat bashkiake të bujqësisë e pyjeve për fermerët e zonave në risk për kulturat bujqësore, bimët medicinale etj.<br>3. Mbështetje nga strukturat e bashkisë dhe atyre qendrore për subvencionim të diferencuar për blegtorinë në zonat e varfra dhe me risk. | | Organet e vetëqeverisjes vendore | Nëntor–dhjetor 2017 | Në vazhdimësi | Çdo 6 muaj | 1. Numri i përfituesve nga qiramarrja.<br>2. Sasia e sipërfaqes së tokës/kullotës të marrë me qira (ha).<br>3. Numri i fermerëve që kanë përfituar subvencion në zonat me risk.<br>4. Numri i personave të punësuar/vetëpunësuar. | Buxhet i bashkive përkatëse |
| | | | 1. Të kryhet rishikimi i ligjeve që | | MM (Forcat e Armatosura) | Menjëherë | Në vazhdimë | | 1. Sasia e sipërfaqes së | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | parashikojnë qiramarrjen e tokës.<br>2. Të kryhet inventarizimi i plotë i tuneleve dhe strehimeve nëntokësore, që janë jashtë administrimit të FA-së dhe të bëhet administrimi i tyre përmes dhënies në përdorim/qira. | | | | si | | tokës të marrë me qira (ha). | |
| A.3 | **Përmirësimi i menaxhimit të kufijve për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të kanabisit, farave dhe mjeteve/pajisjeve të tjera që i shërbejnë kësaj veprimtarie kriminale.** | Parandalimi i futjes se farave/fidanëve të Kanabisit nga shtetet e tjera të BE në Shqipëri, si dhe trafikimit të kanabisit. | 1. Intensifikimi i kontrolleve në PKKK.<br>2. Qarkore PKKK për njohjen e farave/fidanëve/bimës së Kanabisit.<br>3. Bashkëpunimi me doganën për kontrollet në kufi<br>4. Bashkëpunimi me Postën Shqiptare dhe shërbimet e tjera postare. | **PSH (Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit)** | | Viti 2018 e vijimësi | 2018–2020 | Çdo vit | 1. Numri i kontrolleve të ushtruara në kufi.<br>2. Numri i farave/fidanëve/ sasi kanabisi të kapur e sekuestruar.<br>3. Numri i personave/autorë të proceduar penalisht. | Buxheti i Shtetit (Programi Buxhetor Policia e Shtetit) |
| | | | 1. Miratimi i Planit Operacional për evidentimin e zonave me fluks të lartë duke tentuar të mbikëqyret i gjithë territori për fenomene të paligjshme.<br>2. Ristrukturimi i sektorit të hyrje-daljeve të Degës së Doganës Durrës në funksion të përmirësimit të procedurave të kontrollit si dhe vendosja e një skaneri të dytë | | DPD | | | | | Buxheti vjetor (DPD) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | brenda sheshit të eksportit. | | | | | | | |
| | | | Kryerja e patrullimeve dhe monitorimi nëpërmjet SIVHD i hapësirës detare. | | MM | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | | 1. Numri i orëve të lundrimit të kryera.<br>2. Numri i operacioneve antikanabis në det.<br>3. Numri i objekteve detare të zbuluara | Buxheti vjetor (Ministria e Mbrojtjes) |
| | | | Monitorimi i vijës bregdetare me burime informacioni. | | SHISH | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | | 1. Numri i burimeve të informacionit | Buxhet vjetor (SHISH) |
| A.4 | **Rritja e efektivitetit të burimeve për mbledhjen e informacionit dhe rritja e hetimeve proaktive për parandalimin dhe goditjen e kultivimit dhe trafikimit të Kanabisit.** | Përmirësimi i burimeve të informacionit dhe rritja e hetimeve proaktive për dokumentimin ligjor e vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve/grupeve kriminale të kultivimit dhe trafikimit të Kanabisit. | 1. Analizimi i informacioneve dhe burimeve RSI, kryerja e tërheqjeve të kandidaturave të reja.<br>2. Grumbullimi dhe shkëmbimi i informacioneve me SHISH dhe SHCBA për persona e grupe kriminale që merren me kultivimin dhe trafikimin e kanabisit.<br>3. Kryerja e trajnimeve me qëllim shkëmbimin e eksperiencave mbi tendencën e kultivimit të kanabisit në ambiente të mbyllura. | **Policia e Shtetit (strukturat e hetimit të krimit)** | SHISH SHÇBA institucionet e tjera të TFQ-ve | Viti 2018 e vijimësi | 2018–2020 | çdo vit | 1. Numri i informacioneve policore, i informacioneve të organeve të tjera ligjzbatuese SHISH e SHCBA.<br>2. Numri i procedimeve proaktive.<br>3. Numri i autorëve të proceduar nga hetimet proaktive. | Fondi i veçantë për shpërblimin e RSI-së; Buxheti i Shtetit (Programi Buxhetor Policia e Shtetit) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1. Përditësimi dhe analizimi i të dhënave të organeve ligjzbatuese, përdorimi i informacionit të siguruar nga partnerët ndërkombëtarë, intensifikimi i hetimeve komplekse dhe të përbashkëta, duke përfshirë edhe aplikimin e metodave speciale të hetimit, mundëson zbulimin dhe goditjen e grupeve kriminale (financuesve, organizatorëve, trafikantëve, ndërlidhës, kultivues dhe shpërndarës;<br>2. Njësia e inteligjencës financiare shtetërore, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), strukturat e inteligjencës, të prokurorisë, të policisë, të hetimit tatimor dhe doganor të ndërtojnë njësi të përbashkëta dhe në bashkëpunim me struktura partnere homologe ndërkombëtare, të mbledhin dhe të analizojnë informacionin për të arritur hetimin | | Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave | DPPP, menjëherë me fillimin e zbatimit të Planit; PSH për masat e tjera që ka shtuar në vijimësi, ndërsa trajnimi 3-mujori i parë | Në vazhdimësi | | 1. Numri i grupeve kriminale të identifikuara.<br>2. Numri i grupeve kriminale të goditura/shkatërruara.<br>3. Vlera e aseteve kriminale të zbuluara dhe të sekuestruara.<br>4. Numri i çështjeve të referuara në prokurori.<br>5. Numri i personave të dënuar.<br>6. Lista e personave të proceduar/dënuar për kultivim të kanabisit.<br>7. Numri i informacioneve policore SK_2, numri i informacioneve nga SHISH dhe SHCBA - rezultati i tyre.<br>8. Numri i hetimet proaktive me metoda speciale të hetimit dhe numri i | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | kompleks dhe procedimit penal të suksesshëm.<br>3. DPPP-ja dhe njësitë e përbashkëta hetimore të financave të intensifikojnë bashkëpunimin dhe inspektimet e bazuara në subjekte që kanë detyrim të evidentojnë transaksionet financiare si: institucionet bankare, zyrat noteriale, shoqëritë e transfertave monetare, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat e këmbimit valutor, ekspertë kontabël dhe kontabilistë të miratuar, kompanitë e sigurimeve, subjekte të lojërave të fatit, shoqëritë e qiradhënies financiare (*Leasing*) etj.<br>4. Të rishikohet legjislacioni penal për të diferencuar dënimet penale në përpjesëtim me sasitë e lëndës narkotike të kultivuar/ konsumuar/trafikuar. | | | | | | përgjimeve parandaluese - rezultati prej tyre.<br>9. Numri i fluturimeve me helikopter, numri i raporteve, nr.. i parcelave dhe numri i bimëve të asgjësuara.<br>10. Numri i kontrolleve të kryera në territor, numri i grupeve të kontrollit, numri i automjeteve për kontrolle, numri i parcelave të asgjësuara dhe numri i bimëve të asgjësuara.<br>11. Numri i punonjësve të trajnuar.<br>12. Nr. i individëve për të cilët janë kryer verifikime në kuadër të procedimeve penale dhe investigimeve policore.<br>13. Nr. i takimeve të | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | njësive të përbashkëta dhe kontributi i DPPP-së (për diskutim).<br>14. Numri i inspektimeve të kryera.<br>15 Numri/vlera e masave administrative. | |
| | | | Forcimi i koordinimit ndërinstitucional, si dhe të bashkëpunimit me strukturat homologe në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, fokusimi në rritjen e eficiencës së hetimeve, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të hetimeve proaktive me metoda speciale të hetimit, kryerja e operacioneve policore, si dhe hetimeve të përbashkëta ndërkombëtare, mundëson zbulimin dhe goditjen e grupeve kriminale:<br>1. Rritja e numrit të hetimeve proaktive.<br>2. Rritja e përdorimit të metodave special të hetimit.<br>3. Rritja e | Policia e Shtetit (Sektori kundër trafikimit të bimëve narkotike) | | | Në vazhdimësi | | - Hartimi Strategjisë Kombëtare Kundër Drogës 2017–2021 dhe Plani i saj i Veprimit, hartimi dhe miratimi i akteve në fushën e drogës.<br>- Numri i veprave penale të identifikuara, personat e proceduar.<br>- Numri i grupeve kriminale të goditura /të shkatërruara.<br>- Numri i operacione në bashkëpunim ndërkombëtar të kryera. | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | bashkëpunimit me institucionet e tjera SHISH, SHÇBA dhe Prokurori.<br>4. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar.<br>5. Trajnimi i personelit. | | | | | | - Numri i hetimet proaktive me metoda speciale të hetimit.<br>- Numri i informacioneve të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit. Numri i veprave penale të identifikuara, personat e proceduar. Numri i grupeve kriminale të goditura /të shkatërruara. | |
| | | | Kryerja e hetimeve tatimore | | Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Hetimit Tatimor) | | Në vazhdimësi | | Numri i çështjeve të analizuara dhe dërguar për ndjekje të mëtejshme nga institucioni kërkues i informacionit. | Kostoja administrative |
| | | | Intensifikimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacioneve të institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit. | | | 1.10.2017 | Në vazhdimësi | | Rezultati i Hetimeve dhe numri i çështjeve të ndjekura | Kostoja administrative |
| | | | Nxjerrja e detyrimeve tatimore dhe penalizimi për asetet e | | | 2017 | Në vazhdimësi | | Vlerat e konstatuara të padeklaruara | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | pajustifikuara në zbatim të Ligjit "Për Tatimin mbi të Ardhurat" | | | | | | në Organin Tatimor | |
| | | | Kallëzimi penal në zbatim të nenin 116 "Evazioni Tatimor" të ligjit të Procedurave Tatimore dhe nenit 180 të Kodit Penal për veprën penale "Fshehje të Ardhurash", për shtetasit e konstatuar në shkelje të deklarimit të të ardhurave. | | | 2017 | Në vazhdimësi | | Numri i çështjeve të Referuara në Prokurori dhe rezultati i tyre. | Kostoja administrative |
| | | | 1. Mbledhja dhe përpunimi i informacionit në lidhje me deklarimet CASH (përdorimi i bazës së të dhënave që disponon Drejtoria Antitrafik) dhe trafikimin e lëndëve narkotike për zbulimin dhe goditjen e grupeve kriminale (financuesve, organizatorëve, trafikantëve, ndërlidhës, kultivues dhe shpërndarës). Monitorim/inspektim i degëve Doganore në lidhje me deklarimin CASH në kufi.<br>2. Përmirësimi i procedurave për kontrollin e qarkullimit të parasë në pikat kufitare. | | Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) | 2017 | Në vazhdimësi | | Numri i grupeve kriminale të identifikuara. Numri i grupeve kriminale të goditura/shkatërruara. Numri i aseteve kriminale të zbuluara dhe të sekuestruara. Numri i çështjeve të referuara në prokurori. Numri i personave të dënuar. | Buxheti vjetor (DPD) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 3. Ngritja e një sistemi më të integruar për përmirësimin e ruajtjes së të dhënave për rastet e kapjeve të trafikimit të lëndëve narkotike, e cila do të shërbejë për grumbullimin, përpunimin, analizimin e tyre me qëllim vënien në dispozicion për analizë risku.<br>4. Mbledhja dhe analizimi i informacioneve në lidhje me subjektet që merren me importimin e farërave dhe importimin e fertilizuesve e pesticideve. Përcjellja e këtyre informacioneve pranë institucioneve ligjzbatuese me qellim kryerjen e hetimeve komplekse dhe efikase për të parë nëse këto subjekte apo persona kryejnë transaksione të pajustifikuara, kane xhiro totale vjetore të pajustifikuar etj. | | | | | | | |
| | | | 1. Planifikimi për të krijuar burime me akses të drejtpërdrejtë të grupet kriminale, me bazë brenda e jashtë vendit, të përfshirë veçanërisht në kultivim | | SHISH | Janar 2017 | Në vazhdimësi | | Numri i grupeve kriminale të mbuluar me burime informacioni. | Buxheti vjetor (SHISH) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | të kanabis sativas në vend, tregtim e trafikim të saj. | | | | | | | |
| | | | 2. Rishikimi i mënyrave të bashkëpunimit me DPSH, PKR, DVP në qarqe, për sa i përket thellimit, sqarimit, konfirmimit, ezaurimit të të dhënave që SHISH përcjell/informon këta institucione. | | | Janar 2017 | Në vazhdimësi | | Rezultatet e punës në bashkëpunim. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 3. Rritja e numrit të të dhënave për grupe kriminale të përfshira në këtë aktivitet. | | | Janar 2017 | Në vazhdimësi | | Numri i grupeve kriminale në ndjekje nga policia sipas informacioneve të SHISH. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 4. Rritja e numrit të informacioneve me të dhëna të vërtetuara në rrugë operative, përcjellë për DPSH, PKR, partnerët e huaj. | | | Janar 2017 | Në vazhdimësi | | Numri i grupeve kriminale të goditura nga Policia dhe Prokuroria në bazë të informacioneve të SHISH. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 5. Rritja e numrit të informacioneve të vërtetuar në rrugë operative për PKR, DPPPP, DPSH, për asete monetare e materiale të përfituara nga narkotrafiku, veçanërisht nga ato që lidhen me kultivim, tregtim e trafikim kanabis. | | | Janar 2017 | Në vazhdimësi | | Sasia në vlerë monetare e aseteve të grupeve kriminale të sekuestruara nga Policia dhe Prokuroria në bazë të informacioneve të SHISH. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 6. Përgatitja e raportimeve | | | Janar 2017 | Në vazhdimë | | | Buxheti vjetor (SHISH) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | periodike dhe analizave të riskut për TFQ, MB, Kryeministrin e Shqipërisë, mbi aktivitetet kriminale që lidhen me fenomenin e kultivimit, tregtimit, trafikimit të kanabis sativas. | | | | si | | | |
| | | | 7. Përgatitja e një draftstrukture organizative dhe një draft buxhet më efikas për strukturat kundër narkotikëve në nivel vendor e qendror në SHISH. | | | Tetor 2017 | Dhjetor 2017 | | | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 8. Përgatitja e draft prioriteteve të punës për vitin 2018 për kundërvënien ndaj krimit të organizuar, veçanërisht për kundër narkotikët, fenomenin e kultivimit/tregtimit/ trafikimit të kanabisit, investimit të produktit monetar kriminal të përfituar nga këto veprimtari. | | | Nëntor 2017 | Dhjetor 2017 | | | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | Kryerja e trajnimeve për prokurorë me qëllim marrjen e eksperiencave në metodat dhe teknikat hetimore nga vendet anëtare të BE, për përdorimin e metodave speciale të hetimit, agjent i infiltruar, blerje e simuluar, dorëzim i | | PP | | | | | 10.000.000 lekë (buxheti i Prokurorisë së Përgjithshme dhe donatorë) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | kontrolluar për hetimin e kultivimit/prodhimit/trafikimit të kanabisit. | | | | | | | |
| A.5 | **Goditja e kultivimit që në fazat e hershme të ciklit.** | Përqendrimi i përpjekjeve kryesore te parandalimi i mbjelljes dhe shkatërrimi i fidanëve. | 1. Të ushtrohet kontroll rigoroz i rrugëve të importit dhe pikave të shitjes së farërave nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, doganat dhe tatimet për të parandaluar futjen e farërave të kanabisit në vend.<br>2. Të realizohet bashkëpunimi i hershëm i shërbimeve inteligjente dhe policore me strukturat homologe të vendeve të origjinës së farërave.<br>3. Të intensifikohen kontrollet në serra dhe mjedise të tjera të mbyllura ku mund të kultivohen fidanët.<br>4. Të identifikohen personat që zotërojnë fuqi ekonomike për të mbjellë kanabis.<br>5. Të angazhohen maksimalisht organet e vetëqeverisjes vendore në fazën parandaluese.<br>1. Kontrolli për ndalimin e futjes së farave në territorin e Shqipërisë nga jashtë dhe i shitjes brenda | **Policia e Shtetit** | DPD DPT MBZHR MM MTM ZRPP Organet e vetëqeverisjes vendore SHISH SHÇBA | Shkurt | Shkurt–prill | | 1. Numri i fidanëve të shkatërruar.<br>2. Numri i zonave të identifikuara.<br>3. Numri i personave të përfshirë/procecuar.<br>4. Numri i kontrolleve të kryera në PKK dhe Dogana - sasi e farave të kapura (kg);<br>5. Numri i kontrolleve të kryera në pika shitjes, tregje, fidanishte - sasia e farave të kapura (kg), numri i fidanëve;<br>6. Numri i kontrolleve të kryera në ambiente të mbyllura - sasia e fidanëve të kapur;<br>7. Numri i informacioneve nga SHISH dhe SHÇBA. - Rezultati i | PBA 2019-2020 (Policia e Shtetit) |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | vendit.<br>2. Identifikimi dhe kontrolli. pikave/vendeve të shitjes së farave dhe fidanëve, si dhe i subjekteve që tregtojnë plehra kimike dhe pesticideve.<br>3. Identifikimi dhe kontrolli objekteve/ambienteve të mbyllura me risk për kultivim (serra, objekte ish-ushtarake, ish-rezervat e shtetit, stalla, magazina, shtëpi të braktisura etj.).<br>4. Identifikimi dhe kontrolli zonave/masive pyjore (toke shtet), e veçanërisht i zonave me risk të lartë për kultivim të kanabisit, si dhe i burimeve ujore në këto zona.<br>5. Marrja e informacioneve për posedim/shitje farave apo përgatitjes dhe mbjelljen e fidanëve. | | | | | | tyre. | |
| | | | 1. Identifikimi i rrugëve të importit të farave.<br>2 . Identifikimi i subjekteve që aktualisht importojnë farëra dhe modelimi i profileve të riskut në fazën e parë për | | DPD | | | | Numri i fidanëve të shkatërruar.<br>Numri i zonave të identifikuara.<br>Numri i personave të përfshirë.<br>Evidentimi i | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | rritjen e nivelit të riskut, dhe më pas në fazën e dytë ripërshtatja sipas të dhënave të marra nga institucionet e tjera. | | | | | | subjekteve që importojnë farëra. Evidentimi i subjektet që importojnë fertilizues dhe pesticide të ndryshme. | |
| | | | 1. Monitorimi me burime dhe akses i objekteve / grupeve kriminalë të evidentuar gjatë vitit 2016 si të përfshirë edhe në tregtimin me shumicë të farave të kanabisit në vend. Vëmendje e veçantë për zona *Hot spot* në rrethet: Krujë, Mirditë, Malësi e Madhe, Skrapar, Vlorë, Gjirokastër. | | SHISH | Dhjetor 2016– janar 2017 | Gjatë vitit 2017 | | Evidentimi i shtetasve, grupeve kriminale që importojnë dhe kultivojnë farërat e kanabisit. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 2. Grumbullimi i të dhënave dhe synimi për vërtetimin e tyre në rrugë operative, veçanërisht kur futja dhe tregtimi i farave të kanabisit kryhet nga grupe të krimit të organizuar. | | | Dhjetor 2016– janar 2017 | Gjatë vitit 2017 | | Numri i informacioneve të analizuara dhe vërtetuara me format dhe metodat speciale të punës operative. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 3. Informimi i PKR, DPSH, DVP në qarqe për individë/objekte/ grupe kriminale që kanë futur, apo tentojnë të fusin fara kanabisi në vend, me qëllim kultivimin e kësaj bime. | | | Janar 2017 | Gjatë vitit 2017 | | Numri i produktit informativ për PKR, DPSH dhe DVP për grupet kriminale të farërave të kanabisit. | Buxheti vjetor (SHISH) |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 4. Informimi i PKR-së, DPSH-së, i partnerëve të huaj për grupe të narkotrafikut që do të tentojnë të organizojnë kultivim, tregtim, trafikim të kanabis sativas gjatë vitit 2017. | | | Janar 2017 | Gjatë vitit 2017 | | Numri i produktit informativ për PKR, DPSH dhe DVP dhe partnerët për grupet kriminale të kanabisit. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 5. Bashkëpunim i ngushtë me strukturat e PKR-së, DPSH-së, DVP-së në qarqe, në funksion të ezaurimit të informacionit të përcjellë nga SHISH, me qëllim parandalimin dhe goditjen e këtyre aktiviteteve. | | | Janar 2017 | Gjatë vitit 2017 | | Numri i grupeve kriminale të kanabisit të goditura nga Policia dhe Prokuroria, në bazë të informacioneve të SHISH-it. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 6. Bashkëpunim i ngushtë dhe informim rast pas rasti i MB-së e SHÇBA-së, si dhe i strukturave të tjera ligj zbatuese në vend, që angazhohen direkt në evidentimin, parandalimin dhe goditjen e korrupsionit që favorizon këto veprimtari kriminale. | | | Janar 2017 | Gjatë vitit 2017 | | Intensifikimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet e zbatimit të ligjit. | Buxheti vjetor (SHISH) |
| | | | 1. Identifikimi nga strukturat bashkiake (bujqësisë dhe taksave vendore) të shoqërive tregtare/biznese që tregtojnë farëra, fidanë etj. | | Organet e vetëqeverisjes vendore | Dhjetor 2017 | Në vazhdimësi | çdo 3 muaj | 1. Lista e njësive të biznesit që tregtojnë farëra e fidanë.<br>2. Lista e serrave për | Buxheti i bashkive përkatëse |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2. Identifikimi nga strukturat bashkiake të serrave për çdo fshat.<br>3. Kontrolli nga strukturat e pyjeve e kullotave në bashki për fidanishtet dhe pikat e grumbullimit të bimëve medicinale,<br>4. Bashkërendimi me strukturat qendrore në nivel vendor për kontrollet për farërat, fidanishtet e serrat. | | | | | | çdo fermer.<br>3. Numri i kontrolleve nga çdo sektor në bashki në pikat e shitjes, fidanishte, serra.<br>4. Numri i kontrolleve të përbashkëta: administrata e bashkisë me strukturat qendrore në nivel vendor | |
| | | | Mbajtja nën kontroll e pikave të kalimit doganor për moslejimin e futjes së farës së kanabisit. | | AKU në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe pikat e kalimit kufitar | Në vazhdimësi | Në vazhdimësi | | Numri i kontrolleve të ushtruara, numri i rasteve të konstatuara dhe sasia e farës së sekuestruar. | Kostoja administrative |
| A.6 | **Përmirësimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes ajrore.** | Të rriten kapacitetet e SIVHA nëpërmjet vendosjes së radarëve të rinj dhe vendosjes së kamerave të vëzhgimit ditën dhe natën në helikopterët për të ulur mundësinë e trafikimit të kanabisit nëpërmjet rrugëve ajrore | Blerja dhe instalimi i radarëve dhe kamerave dhe vënia në funksionim e tyre. | **MMB** | PSH<br>Struktura partnere ndërkombëtare | 2018 | 2019 | | 1. Numri i parcelave të zbuluara në fluturimet me rrugëkalim.<br>2. Sasia e orëve të fluturimit.<br>3. Numri i objekteve ajrore të zbuluara | Për vitin 2018 - 960.000.000 lekë<br>Për vitin 2019- 560.000.000 lekë<br>Buxhet vjetor (Ministria e Mbrojtjes) |
| | | Mbikëqyrja/monitorimi ajror me avionët e GD Financës për identifikimin e parcelave | 1. Përcaktimi i zonave me risk për kultivim dhe trafikim të kanabisit. | **Policia e Shtetit** | Misioni Interforce GDF | Prill - tetor 2018 | Prill–tetor 2018–2020 | Çdo vit | 1. Numri i misioneve dhe nr. i fluturimeve | 280.000.000 lekë nga Projekti SANCAS |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të mbjella me kanabis. **(PROJEKTI SANCAS BE).** | 2. Kryerja e fluturimeve ajrore.<br>3. Verifikimi në terren i informacioneve të siguruar nga fluturimet ajrore.<br>4. Asgjësimi i bimëve narkotike, procedimi i autoreve. | | | | | | ajrore; 2. Numri i orëve të fluturimeve;<br>3. Numri i raporteve të monitorimit;<br>4. Numri i parcelave të identifikuara;<br>5. Numri i bimëve të asgjësuara;<br>6. Numri i autorëve të proceduar. | 2017-2019 Kosto e helikopterëve 4.237.350 lekë (PBA 2019-2020 Policia e Shtetit) |
| A.7 | **Parandalimi, identifikimi, zbulimi, dokumentimi, goditja dhe shkatërrimi i grupeve kriminale të trafikimit.** | Shënjimi dhe shkatërrimi i grupeve kriminale të organizuara, të përfshira në trafikimin e kanabisit (financuesit, organizatorët, trafikantët e drogës, ndërlidhësit, kultivuesit, shpërndarësit). | 1. Të bëhet trajnim i posaçëm i personelit të policisë kriminale.<br>2. Të shtohen kapacitetet logjistike të dedikuara.<br>3. Të zgjerohet rrjeti i informatorëve të policisë kriminale.<br>4. Të frenohen lëvizjet e shpeshta të personelit të aktivizuar në PKKK.<br>5. Të organizohen operacione të përbashkëta kombëtare e ndërkombëtare.<br>6. Të merret dhe shkëmbehet sa më shpejt dhe në mënyrë efikase informacioni dhe të vihet në eficiencë sistemi ERICP.<br>7. Të intensifikohet kontrolli i territorit, përmes angazhimit të të gjitha | **Policia e Shtetit** | MFE<br>Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes<br>SHISH<br>SHÇBA<br>PP<br>Partnerë të tjerë relevantë<br>Organet e vetëqeverisjes vendore | | | | | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | strukturave kompetente: PSH, FA, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), strukturat e qeverisjes vendore, strukturat e bujqësisë, pyjeve, mjedisit, tatimeve dhe doganave.<br>8. Të përmirësohet baza e të dhënave, nëpërmjet përditësimit cilësor të informacionit.<br>9. Të fuqizohen kapacitetet analizuese, në funksion të njohjes së situatës kriminale.<br>10. Të shtohen hetimet proaktive dhe përdorimi i metodave speciale të hetimit, për sigurimin e provave ligjore dhe goditjen efektive të grupeve kriminale.<br>11. Të sekuestrohen e konfiskohen asetet kriminale. | | | | | | | |
| | | | 1. Përmirësimi i profileve të skanimit nga ana e DPD-së.<br>2. Nxjerrja e një Urdhri mbi përzgjedhjen për skanim në eksport apo transit ndërkombëtar, jashtë përzgjedhjes nga sistemi automatik i menaxhimit të riskut;.<br>3. Nxjerrja e një | | DPD | | | Sipas Vendimmarrjes së KMR-së nr. 10657 prot., datë 3.5.2017 vetëm për skanimet në eksport. | | Kostoja administrative |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | udhëzimi procedural për procedurat e skanimit.<br>4. Nxjerrja e një udhëzimi procedural për eksportin dhe rieksportin.<br>5. Pjesëmarrje në operacionet e përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare. | | | | | | | | |
